

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*  
**Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance**

---

**PROGRAMI PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE  
DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT**

**(2021-2025)**

Tetor 2021

## PËRMBAJTJA:

1.0 Përmbledhje ekzekutive.....	5
2.0 Hyrja.....	6
3.0 Metodologjia.....	8
4.0 Sfondi.....	9
4.1 Efikasiteti i institucioneve në zbatimin e të drejtave të njeriut.....	15
4.2 Qasja në sistemin e drejtësisë.....	16
4.3 Mbrojtja sociale dhe shëndetësore.....	23
4.4 Mbrojtja e mjedisit.....	28
4.5 Barazia dhe mbrojtja nga diskriminimi.....	31
5.0 Objektivat strategjike dhe objektivat specifike.....	44
5.1 Objektiva strategjike # 1: Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut .....	44
5.2 Objektiva strategjike # 2: Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut.....	45
5.3 Objektiva strategjike # 3: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë.....	46
5.4 Objektiva strategjike # 4: Lehtësimi i Qasjes në Sistemin e Drejtësisë.....	47
6.0 Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit.....	49
6.1 Mekanizmat zbatues.....	49
6.2 Mekanizmat monitorues.....	49
7.0 Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i Programit.....	51
8.0 Ndërlidhja e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (2021-2025), me SDG (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm).....	53

## Lista e shkurtesave dhe akronimeve

<b>ABGJ</b>	Agjencia për Barazi Gjinore
<b>AD</b>	Akademia e Drejtësisë
<b>ANJF</b>	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>DPSA</b>	Dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>IAK</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit
<b>IKAP</b>	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
<b>IKDN</b>	Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut
<b>IKSHPK</b>	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
<b>KE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>KNDESK</b>	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>KPMK</b>	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës
<b>LGBT</b>	Lezbike, gej, biseksuale dhe transgjinore
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit rural
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>MKK</b>	Ministria për Komunitete dhe Kthim
<b>MKKT</b>	Mekanizmi Kombëtar kundër Torturës
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
<b>MMPHI</b>	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
<b>MPBAL</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>OHCHR</b>	Zyra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>PKZMSA</b>	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
<b>QKRMT</b>	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
<b>SDG</b>	..Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm/ Sustainable Development Goals
<b>SHKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës

**UNHCR** Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatë  
**ZKM/ZQM** Zyra e Kryeministrit / Zyra për Qeverisje të Mirë  
**ZL/ZKM** Zyra Ligjore/ Zyra e Kryeministrit

## 1.0 Përmbledhje ekzekutive

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë bazë e shoqërisë demokratike. Liria e garantuar fuqizon individin, rrit obligimet e shtetit në krijimin e ambientit që siguron respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, e ngrit vetëdijen mbi ruajtjen e dinjitetit e integritetit personal. Ashtu siç janë të definuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës e në instrumentet ndërkombëtare të aplikueshme drejtpërdrejt në shtetin e Kosovës, këto të drejta duhen implementuar. Për këtë, Qeveria e Republikës së Kosovës miraton këtë Program për të Drejtat e Njeriut 2021-2025 (këtu e tutje referuar si: "Programi për të Drejtat e Njeriut" ose "Programi") duke synuar zhvillimin socio-ekonomik të bazuar mbi largimin e pengesave ndaj përmbushjes së të drejtave dhe lirive themelore, përfshirë atyre ekonomike, që do të ndihmojnë qytetarin të punojë, kursejë, konsumojë dhe të jetojë me dinjitet e në paqe. Mbi supet e Republikës qëndron përgjegjësi e madhe: të sigurojë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke respektuar standardet e mishëruara në konventa ndërkombëtare e atyre brenda praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përderisa është në duart e Qeverisë të hartojë strategji dhe të përcaktojë politika në drejtim të përmbushjes së normave kushtetuese, është obligim i gjyqësorit të sigurojë respektim të plotë të të njëjtave. Rrjedhimisht, sinergjia ndërmjet pushteteve duhet të sigurojë atë që veçse duhet trajtuar si aksiomë: respektimin dhe implementimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Të gëzosh të drejtat e tua të garantuara, nënkupton gëzim të lirive sociale e ekonomike që sigurojnë qasje më të mirë ndaj informacionit, hapjes ndaj tregut të gjerë, përmirësim të standardit të jetesës dhe së fundmi - reduktimit të varfërisë, problemit sistemik në Republikën e Kosovës. E kjo e fundit paraqet edhe qëllimin themelor e të fundit të Kombeve të Bashkuara të cilat, përmes Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm ("Sustainable Development Goals" apo "SDG"), tentojnë të arrijnë pikërisht këtë deri në vitin 2030, në nivelin global.

Lidhur me këtë, Qeveria ka afirmuar përkushtimin e plotë të saj për përmbushjen e Agjendës së Kombeve të Bashkuara - 2030. Me hartimin e këtij Programi për të Drejtat e Njeriut, tashmë në mënyrë vullnetare është bërë pjesë e përpjekjeve globale që të marrë përsipër të gjitha obligimet e nevojshme për të kontribuar në zbatimin e Rezolutës 70/1 "Transformimi i botës sonë: Agjenda e 2030 për zhvillim të qëndrueshëm"<sup>1</sup>. Andaj edhe objektivat strategjike të synuara janë të lidhura ngushtë me SDG-të.

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut parasheh këto objektiva strategjike:

- # **Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe i llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut;**
- # **Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut;**
- # **Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë;**
- # **Lehtësimi i Qasjes në Sistemin e Drejtësisë.**

---

<sup>1</sup> Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development:  
<https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>

Implementimi i pakompromis i këtij Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njerut, do të zgjerojë diapazonin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore, e kjo e fundit do hapë dyert drejt qasjes më të mirë ndaj ideve dhe informacionit. Qasja e këtillë, në kombinim, fuqizon individin, rrit kualitetin e jetës dhe zgjeron mundësitë e përmbushjes së nevojave sociale e ekonomike.

Programi i paraparë tenton të adresojë sfidat aktuale, përfshirë këtu edhe luftën kundër pandemisë. Marrë parasysh këtë të fundit, ndër fokuset kryesore është ndihma dhe njëkohësisht, ndikimi në rritjen e shëndetit fizik dhe mendor, të ndërlidhur me shkaqet e shkaktuara nga pandemia. Po ashtu, Programi është i dizajnuar ashtu që të përmbush caqet e parapara me SDG-të dhe të ofrojë kushte të favorshme legislative e institucionale, për realizim të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Së fundmi, duhet nënvizuar që Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, do jetë i shoqëruar me Planin e Veprimit 2021-2023 (këtu e tutje referuar si: Plani i Veprimit), dhe si i tillë do të shërbejë si udhërrëfyes dhe udhëzues konsenzual për përmbushjen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

## 2. Hyrje

Hartimi i Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (2021-2025), është obligim që del nga Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi Nr. 05/L -021, saktësisht neni 10 i cili obligon Zyrën për Qeverisje të Mirë të hartojë politika, strategji dhe plane të veprimit në çështjet për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ky Program është ndërtuar mbi parimet që përcaktojnë qartë se të drejtat e njeriut janë të drejta të natyrshme, të pandashme, të patjetërsueshme dhe universale. Kushtetuta e Republikës së Kosovës proklamon dhe garanton parimin për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithëve para ligjit. I bazuar mbi këto parime, Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut synon të arrijë:

- ✚ Barazinë para ligjit, paprekshmërinë e të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve shtetërore, dhe mbrojtjen nga shkelja e të drejtave të njeriut nga të tjerët;
- ✚ Krijimin e një sistemi të qëndrueshëm institucional i cili do t'i lejojë personat të realizojnë dhe zbatojnë të drejtat e tyre në praktikë;
- ✚ Informimin adekuat të popullsisë për të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, ligje dhe instrumente ndërkombëtare.

Përmes Programit, Qeveria e Kosovës do t'i përmbushë detyrimet pozitive që dalin nga njohja e çdo të drejte universale të njeriut, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Brenda këtij kuadri të gjithë personave u jepet mundësia të gëzojnë të drejtat e tyre, përderisa gëzimi i tyre nuk cenon të drejtat e të tjerëve. Në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit si një mekanizëm i pavarur për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, Komisionit Evropian, OJQ-ve vendore dhe mekanizmave ndërkombëtarë dhe rajonal për të drejtat e njeriut do të merren parasysh, dhe të njëjtat do të zbatohen nga ana e institucioneve kompetente konform Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi.

Për më tepër, Qeveria e Kosovës do të respektojë në plotni obligimet e saj në raport me vlerësimet e organizmave përgjegjës për caktimin e standardeve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, e do konsiderojë si prioritar, adresimin adekuat të vlerësimeve të pranuar.

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut do të jetë në fuksion të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit me BE-në, realizimit të prioriteteteve të parapara në Programin e Punës së Qeverisë së Kosovës (2021-2025), arritjes dhe zbatimit të Objektivave për zhvillim të Qendrueshëm (SDG), Programit për Reforma Ekonomike (ERA), Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) 2, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH), si dhe dokumenteve tjera strategjike në fushën e të drejtave të njeriut. Njëkohësisht, ky Program thekson edhe prioritetet e programit qeverisës lidhur me sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe promovimin e mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve.

Programi po ashtu, ndërlidhet dhe plotësohet nga programe dhe strategji tjera sektoriale që adresojnë fusha specifike të të drejtave të njeriut, si:

**Programi i Kosovës për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (2017-2021)**, përmban një sërë të aktiviteteve të cilat duhet ndërmarrë institucionet e Kosovës, përfshi edhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kuadër të bllokut demokracia dhe sundimi i ligjit si dhe në respektimin e të drejtave themelore të njeriut;

**Programi i Reformave Ekonomike (PRE) 2020-2022** – synon përveç tjerash realizimin e aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me përmirësime të kornizës ligjore, shërbimeve sociale dhe ndihmave sociale, fuqizimin e mekanizmave të financimit dhe decentralizimit të shërbimeve sociale përmes krijimit të Grantit të Veçantë të Shërbimeve Sociale, reformimin e Skemës së Ndhmës Sociale, mbështetjen e sektorit joqeveritar të licencuar për shërbime sociale, mbështetjen e ndërmarrjeve sociale të regjistruara dhe ngritjen e kapaciteteve të punëtorëve social përmes zbatimit të programeve të trajnimit;

**Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (2020-2024)**- i cili synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve;

**Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Shoqërinë Kosovare 2017-2021** e cila fokusin e ka në sigurimin efektiv të të drejtave të këtyre komuniteteve, në veçanti qasjen në arsim, punësim, shërbime shëndetësore dhe banim;

**Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018-2022**, e cila synon të rrisë punësimin dhe përmirësojë e rritë mirëqenien sociale për grupet e rrezikuara përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë së mbrojtjes dhe shërbimeve sociale e familjare, me fokus të veçantë për kategoritë sociale;

**Strategjia Kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë**, e cila synon të ofrojë vizionin strategjik për sigurimin e implementimit të të drejtave pronësore. Kjo Strategji i përcakton prioritetet dhe fazat e intervenimeve me qëllim të përkufizimit të qartë me ligj të të drejtave pronësore, dhe ofron mekanizma efikas, të qasshëm dhe të përbalueshëm përmes të cilëve kosovarët do të mund të bëjnë formalizimin e të

drejtave të tyre pronësore përmes regjistrimit në kadastrin e Kosovës. Të drejtat pronësore të legalizuara dhe regjistruara në kadastrin e Kosovës pastaj mund të zbatohen në mënyrë shumë më efektive dhe konsistente nga gjykatat dhe agjencitë shtetërore duke ofruar kështu siguri më të madhe;

**Strategjia Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020**, e cila synon të krijojë një shoqëri që iu siguron të gjithë shtetasve të saj, të rritur dhe fëmijë, të jetojnë pa frikën apo kërcënimin e dhunës në familje, që mbron viktimat, vendos kryesit përpara përgjegjësisë dhe zvogëlon tolerancën e publikut ndaj veprimeve të dhunshme në familje;

**Strategjia për Rregullim më të Mirë 2017-2021**, e cila përveç tjerash synon të reformojë legjislacionin primar dhe sekondar dhe të rrisë efikasitetin e komunikimit dhe konsultimit publik. Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar ndaj parimeve për **zbatimin e duhur të politikave dhe legjislacionit**. Sa i përket promovimit të vazhdueshëm të sundimit të ligjit në Kosovë, ligjet duhet të modernizohen dhe të jenë në përputhje me qëllimin për të cilin janë hartuar. Zbatimi i tyre duhet të kanalizohet dhe të jetë sa me efektive që mundet, sepse kjo do të jetë në dobi të agjencive zbatuese dhe inspektuese e të cilat duhet ta zbatojnë legjislacionin në praktikë.

### 3. Metodologjia

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut është hartuar duke u bazuar në një metodologji të kombinuar në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse, të adresojë prioritetet kyçe të Qeverisë në aspektin e respektimit, mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të njeriut, dhe të sigurojë që intervenimet e përcaktuara do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike. Përgjatë procesit të hartimit të Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut janë organizuar punëtori dhe takime individuale me aktorët kyq vendorë dhe ndërkombëtarë, para se gjithash konsultime me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut<sup>2</sup>. Për të siguruar përfshirjen e të gjithë akterëve, me Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit është krijuar grupi punues për hartimin e këtij Programi. Pas analizës së gjendjes aktuale në fushën e të drejtave të njeriut, janë përcaktuar objektivat strategjike, objektivat specifike, aktivitetet dhe veprimet konkrete, të cilat janë buxhetuar. Në aspektin strukturor dhe përmbajtësor, Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, është hartuar në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, Rregulloren e Punës së Qeverisë Nr.09/2011 dhe Rregulloren (QRK) Nr.05/2016 për Standardet minimale për procesin e Konsultimit Publik. Procesi i hartimit të Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut ishte i ndarë në tri faza: 1) faza e parë është karakterizuar me analizimin e situatës së përgjithshme, si dhe realizimin e takimeve konsultative<sup>3</sup>, në të cilat kanë qenë të përfshirë zyrtarë dhe përfaqësues relevant nga

---

<sup>2</sup> Me dt.01 Prill 2019, është mbajtur takimi me koalicionin e organizatave joqeveritare "ERAC".

<sup>3</sup> Me përkrahjen e OSBE-së, janë mbajtur takimet konsultative në 6 (gjashtë) regionet e Kosovës, duke përfshirë regionet e (Prizrenit, Ferizajt, Gjakovës, Pejës, Mitrovicës, dhe Gjilanit).



niveli lokal i qeverisjes; 2) përgjatë fazës së dytë, ekipi përgjegjës për hartimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut ka analizuar dokumentet strategjike në fuqi<sup>4</sup>, raporte e vlerësime të ndryshme vendore e ndërkombëtare dedikuar të drejtave të njeriut. Në veçanti është vënë në theks te Raportet vjetore të Komisionit Evropian për Kosovën, Raportet e Avokatit të Popullit, konkluzionet e dala nga takimet e nivelit të lartë si ato të Dialogut të Procesit të Stabilizim Asocimit (DPSA), dhe nga Takimet e Nën-komitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri, Nënkomitetit për Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikë Sociale në kuadër të zbatimit të MSA-së, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)<sup>5</sup>, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën 2018/2019, Korniza ligjore për të drejtat e njeriut, e me fokus të veçantë Pakoja e ligjeve për të Drejtat e Njeriut<sup>6</sup>, e shumë raporte dhe hulumtime relevante dhe kredibile nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare, raportet analitike dhe vlerësuese të organizatave vendore dhe ndërkombëtare, vlerësimet e Raportuesve Special të OKB-së në fusha të ndryshme të të drejtave të njeriut. Së fundmi, në fazën e tretë Programi i është nënshtruar procesit të konsultimeve publike, ku ekipi punues ndërinstitucional ka shqyrtuar dhe inkorporuar komentet e pranuar dhe konfirmuar procedurave në fuqi është proceduar për aprovim.

#### 4. SFONDI

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në Republikën e Kosovës janë të mbrojtura dhe rregullohen sipas parimeve të parapara me Kushtetutë. Kushtetuta e Kosovës parasheh që dispozitat e instrumenteve ndërkombëtare si dhe atyre rajonale mbi të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe kanë epërsi mbi legjislacionin kombëtar<sup>7</sup>. Kuvendi i Kosovës me 25 Shtator 2020 miratoi ndryshimet kushtetuese të cilat i japin efekt të drejtpërdrejtë mbrojtjes dhe zbatimit të drejtave të përfshira në Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ("Konventa e Stambollit"). Neni 53 i Kushtetutës, i detyron Institucionet e Kosovës të interpretojnë dispozitat në lidhje me të drejtat dhe liritë e njeriut në përputhje me juridiksionin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Zbatimi i drejtpërdrejtë i dispozitave të instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut nga gjykatat e rregullta dhe administrata publike, ashtu siç kërkohet sipas Kushtetutës, kërkon njohuri dhe ekspertizë. Përveç Gjykatës Kushtetuese të Kosovës që ka justifikuar vendimet e saj bazuar në juridiksionin (praktikën) e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, institucionet e tjera kombëtare që përfshijnë gjykatat dhe administratën e rregullt nuk ishin në gjendje të drejtpërdrejtë të interpretojnë dhe zbatojnë dispozitat e instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.<sup>8</sup>

Megjithatë, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK), vazhdon ende të jetë jashtë listës së instrumenteve ligjore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Deri në

---

<sup>4</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Regjistri\\_i\\_dokumenteve\\_strategjike\\_në\\_fuqi\\_.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Regjistri_i_dokumenteve_strategjike_në_fuqi_.pdf).

<sup>5</sup> <https://www.un.org/sustainabledevelopment/>;

<sup>6</sup> Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Avokatin e Popullit.

<sup>7</sup> Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës, "Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare".

<sup>8</sup> Raporti, Një sistem i shfrytëzuar pak: Gjendja e Kornizës së të Drejtave të Njeriut në Kosovë.

një moment të përshtatshëm për inicimin e përfshirjes së kësaj Konvente në Kushtetutë, përpjekjet duhet orientuar në harmonizimin e legjislacionit me këtë Konventë. Avokati i Popullit edhe në raportet paraprake vjetore, e ka ngritur këtë çështje, e cila ka një rëndësi të veçantë, sepse do ta kompletonte më tej listën e instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë dhe njëherësh do të ndikonte në avancimin e mbrojtjes së të drejtave ekonomiko, sociale dhe kulturore në vend.

Themelimi i Këshillit të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kosovës dhe miratimi i Agjendës 2030 dhe SDG-ve, nga Kuvendi i Kosovës, ofrojnë një pikë të fortë hyrëse për promovimin e realizimit të (KNDESK), në Kosovë.

Kuadri ligjor garanton gjerësisht mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore në përputhje me standardet evropiane. Sidoqoftë, zbatimi i legjislacionit dhe strategjive shpesh minohet nga burime të pamjaftueshme financiare dhe burime të tjera, veçanërisht në nivelin lokal, prioritizimi i kufizuar politik dhe mungesa e koordinimit<sup>9</sup>.

Bazuar në Raportin e Vendit<sup>10</sup>, institucionet e Kosovës duhet t'i japin përparësi më të lartë politike mbrojtjes së të drejtave themelore dhe të sigurojnë kapacitete e burime buxhetore të përshtatshme për zbatimin dhe promovimin e tyre, përfshirë shërbimet kryesore dhe ndihmën për grupet e cenueshme<sup>11</sup>.

Bazuar në Raportin e Vendit nga paragrafi paraprak, sa i përket të drejtave themelore, strategjitë dhe politikat duhet të harmonizohen dhe të sigurohet mbikëqyrja e duhur. Qeveria duhet t'i marrë më seriozisht të drejtat themelore dhe t'i përfshijë ato më lart në agjendën politike. Mekanizmat ekzistues të të drejtave të njeriut duhet të forcohen<sup>12</sup>. Koordinimi i qeverisë për mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe atyre të pakicave, si në nivelin qendror dhe atë lokal, duhet të përmirësohet dhe çështjet e të drejtave themelore duhet të zënë vend më lart në agjendën politike.<sup>13</sup>

Përtej problemeve sa i përket zbatimit të ligjeve, gjithashtu ekziston një mungesë e të dhënave cilësore dhe statistikore për statusin ose gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Një gjë e tillë është konkluduar poashtu në Raportin e Vendit për Kosovën për vitin 2020<sup>14</sup>.

Për më tepër, të dhënat statistikore shpesh nuk janë të ndara sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar etj. Mungesa e statistikave të azhurnuara të besueshme prekë të gjithë sektorët dhe rrjedhimisht kjo çështje duhet të adresohen urgjentisht. Sidoqoftë, vendosja e një sistemi për monitorimin e të drejtave të njeriut në nivel vendi është e domosdoshme.

---

<sup>9</sup> Shih, Raporti i Vendit për Kosovën 2020, fq.6.

<sup>10</sup> Shih, Raporti i Vendit për Kosovën 2018, fq.14.

<sup>11</sup> Kategoritë e cenueshme të tilla si personat me aftësi të kufizuara, të kthyerit, personat e zhvendosur brenda vendit, refugjatët, azilkërkuesit, personat pa shtetësi, anëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane, LGBT, nënat vetushqyese, të mbijetuarat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore etj.

<sup>12</sup> Shih, Raporti i Vendit për Kosovën 2020, fq.16.

<sup>13</sup> Shih, Raporti i Vendit për Kosovën 2020, fq.28.

<sup>14</sup> " Është arritur pak progres në përmirësimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave pas rekomandimeve të Eurostat dhe me ratifikimin e ligjit të ndryshuar për statistikat. Komunikimi midis institucioneve statistikore u përmirësua pak, por koordinimi në nivelin teknik dhe përdorimi i burimeve të të dhënave administrative në dispozicion duhet të përditësohen", Shih, Raporti i Progresit për Kosovën, 2020, në: <https://www.mei-ks.net/sq/raporti-i-progresit-585>.

Bazuar në të gjeturat e raporteve të fundit për të drejtat e njeriut në Kosovë, theksohet se qasja e plotë në realizimin e të drejtave të njeriut është e kufizuar, nga njëra anë nga mungesa e vetëdijes së qytetarëve për mjetet në dispozicion me të cilat zbatohen të drejtat e tyre, dhe nga ana tjetër përmbushja joadekuatë e detyrave dhe përgjegjësi në funksion të zbatimit të ligjeve nga institucionet kompetente.

Përveç mos reagimit në kërkesat e qytetarëve, autoritetet përkatëse ekzekutive kanë përgjegjëshmëri të ulët ndaj kërkesave dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit si një mekanizëm i rëndësishëm dhe i pavarur për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Shqetësuese mbetet, zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet përkatëse e cila arrin 54%<sup>15</sup>. Edhe pse Ligji për Avokatin e Popullit përcakton një detyrim për të raportuar mbi veprimet e ndërmarra për të trajtuar rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit, shumë institucione nuk arrijnë ta bëjnë një gjë të tillë në kohën e duhur<sup>16</sup>.

Përkundër garancive kushtetuese dhe ligjore, nuk janë të pakta rastet e diskriminimit të shkaktuara qoftë në sektorin publik apo privat. Gjatë vitit raportues 2019<sup>17</sup>, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga qytetarët lidhur me diskriminimin në marrëdhëniet e punës. Natyra e ankesave ka të bëjë me shkelje të së drejtës për punë në procedurat e konkurseve për zgjedhje dhe avancime, pastaj edhe me ngacmim seksual në vendin e punës. Përveç ankesave të paraqitura nga qytetarët, Avokati i Popullit ka hapur 21 raste për hetim sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*). Gjithashtu, Avokati i Popullit, me konstatime për diskriminim, ka publikuar 7 Raporte me rekomandime në cilësinë e Mikut të Gjykatës (*Amicus Curiae*), i është drejtuar gjyqësorit në 5 raste dhe në 2 raste ka paraqitur Opinione.

Vetëm gjatë vitit 2018, Inspektorati i Punës ka pranuar 515-të ankesa formale lidhur me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Institucionet kompetente duhet që ankesat e pranuarat t'i ndajnë sipas gjinisë së ankuesit/es, sepse kjo do të kontribuonte në qartësimin dhe evidentimin e nivelit të rasteve të diskriminimit me bazë gjinore, në sektorin publik dhe sidomos në sektorin privat. Gjithashtu, pozita e të punësuarve vazhdon të jetë e rëndë sidomos në sektorin privat, ku përgjithësisht nuk ka organizata sindikale që do t'i mbronin të drejtat e punëtorëve. Niveli i sigurisë në punë, sidomos në sektorin privat mbetet shqetësues, shpesh pa mbrojtje elementare, e për këtë arsye rezulton që për shkak të mungesës dhe mosmarrjes së masave të duhura të sigurisë në punë, kemi një numër të madh të rasteve të vdekjeve dhe lëndimeve të rënda të punëtorëve në vendin e punës me theks të veçantë në sektorin e ndërtimit<sup>18</sup>.

Aktualisht, infrastruktura ligjore në fushat dhe sektorët e ndryshëm të të drejtave të njeriut në përgjithësi është në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, mirëpo ende ka sfida lidhur me zbatimin e saj në praktikë. Kjo vjen si pasojë e mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare; mungesës së

---

<sup>15</sup> Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2019, fq.80.

<sup>16</sup> "Një sistem i shfrytëzuar pak: Gjendja e Kornizës së të Drejtave të Njeriut në Kosovë", 28.08.2017.

<sup>17</sup> Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2019, fq.9.

<sup>18</sup> Vdekjet e heshtura, dhjetor 2018 Iniciativa Kosovare për Stabilitet IKS, faqe 2 qasur me 28.01.2019, 20 vdekje në vendin e punës e përcjellën Kosovën nga janari deri në dhjetor, shumica e të cilave nga mungesa e masave të sigurisë në vendin e punës sidomos në sektorin e ndërtimitarisë.


njohurive të nevojshme për ligjet e reja; rastet e identifikuar nga Avokati i Popullit kur Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligje, të cilat, për nga përmbajtja e tyre janë në kolizion me ligjet e tjera në fuqi<sup>19</sup>; mungesa e praktikës unike për rastet e njëjta; mungesa e vullnetit për zbatimin e drejtë të normave si rezultat i ndikimit të interesave të ndryshme të grupeve të interesit<sup>20</sup>; mungesës së ekspertizës profesionale dhe pengesave administrative e nganjëherë edhe për shkak të mungesës së vullnetit politik.

Sa i përket realizimit të të drejtave të njeriut, sfidë mbetet përmirësimi i zbatimit të kuadrit ligjor ekzistues dhe zbatimi i vendimeve (**gjyqësore e administrative**) që rregullojnë shkeljet e të drejtave të njeriut. Realizimi i të drejtave të njeriut në praktikë nënkupton ekzistencën e mundësive dhe mekanizmave për dëmshpërblim-kompensim në rastet e shkeljeve të këtyre të drejtave<sup>21</sup>.

Kosova ka krijuar me sukses programin e parë funksional të kompensimit të viktimave në rajon. Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit është miratuar në vitin 2015 dhe bazuar në të njëjtin, është krijuar Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve në vitin 2016.

Sidoqoftë, vetëm në vitin 2017 programi u bë funksional, kur Ministria e Financave (MF) ka ndarë buxhetin e parë prej 100.000 (njëqindmijë) euro. Komisioni shqyrton dhe vendos për kërkesat e pranuar nga personat të cilët pretendojnë se janë viktima të krimit.

Deri në fund të vitit 2019, Komisioni ka aprovuar 15 raste për kompensim. Sipas Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, viktimat kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për kategorinë e veprave penale të listuara në Fig 1 (të paraqitur më poshtë). Meqenëse ka pasur mangësi ligjore në këtë Ligj të cilat e kanë vështirësuar qasjen e viktimave në programin e kompensimit, mirëpo edhe e kanë cenuar dinjitetin e tyre specifikisht për shkak të kriterëve për kompensim, Qeveria e Kosovës ka miratuar Koncept Dokumentin për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Koncept Dokumenti propozon ndryshimin e Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjegjësisht të dispozitave që rregullojnë veprat e kompensueshme, kushtet formale dhe materiale për kompensim, qasjen e menjëhershme në kompensim, obligimin për të kërkuar dëmshpërblim, llojet e kompensimeve, afatet ligjore, etj.



<b>Vrasja</b>
<b>Trafikimi me genie njerëzore</b>
<b>Dhunimi</b>
<b>Keqpërdorimi seksual i fëmijëve</b>
<b>Veprat penale të cilat bien në domenin e Ligjit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje</b>

**Fig .1 Ligji Nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit ka listuar pesë (5) kategori primare të veprave penale, viktimat e të cilave kanë të drejtë të përfitojnë nga ky ligj.**

<sup>19</sup> Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2019, fq.21.

<sup>20</sup> Shih komentarin e Ligjit për barazi gjinore (parathënie).

<sup>21</sup> QKRMT përkujton faktin se lartësia e shumës së kërkuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës në emër të kompensimit për shkeljen e të drejtave të njeriut në vitin 2018 kishte arritur në 2 milion euro, ndërsa KGJK ka pasur në dispozicion vetëm 0.5 milion për këtë qëllim.

Fondi për Kompensimin e Viktimave të Krimit<sup>22</sup> që funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, shumë pak është promovuar në opinionin publik. Qytetarët dinë shumë pak për ekzistencën e tij, procedurat dhe kushtet që aplikohen ndaj një të drejte për kompensim dhe vetëm një numër i kufizuar i drejtohet Komisionit për realizimin e kësaj të drejte. Institucionet të cilat bien në kontakt me viktimën (policia, avokatët e viktimave, institucionet shëndetësore dhe sociale, gjykatat dhe prokuroritë), duhet ta njoftojnë viktimën lidhur me të drejtën për kompensim konform obligimeve ligjore.

Një tipar tjetër i cili e ka përcjellë gjithë legjislacionin e miratuar deri më tani është mungesa e konsistencës gjuhësore dhe terminologjike e ligjeve. Një dukuri e këtillë, përveç vështirësive në zbatim adekuat të ligjeve sjellë vështirësi edhe në interpretim gjatë zbatimit dhe krijon pasiguri juridike të zbatuesit gjithashtu. Prandaj është e nevojshme që të bëhet standardizimi i terminologjisë juridike në formën e një fjalori juridik dhe gjithashtu të ketë një verifikim kualitativ gjuhësor të ligjeve para miratimit përfundimtar në Kuvend<sup>23</sup>.

Në të njëjtën kohë, koncepti i qeverisjes së mirë karakterizohet jo vetëm duke bërë rregullimet e nevojshme ligjore, por edhe nëpërmjet zbatimit të saj të duhur. Me qëllim të përmirësimit të sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, është e nevojshme të zhvillohet më tej kuadri ligjor për fusha dhe sektorët ku ka nevojë, qoftë në hartimin, harmonizimin apo plotësim/ndryshimin e ligjeve ekzistuese, duke siguruar në të njëjtën kohë efektivitetin e zbatimit të dispozitave. Kosova ende nuk e ka një ligj gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, mbetet shqetësim kryesor i Qeverisë të sigurojë përputhjen e legjislacionit dhe politikave me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe zbatimin e tyre adekuat.

Edhe pse ekziston një kornizë solide ligjore dhe institucionale për ofrimin e shërbimeve sociale, megjithatë ajo duhet të plotësohet me fondet dhe burimet e nevojshme. Qeveria duhet të krijojë parametra për një formulë të ndarë të **veçantë financiare për shërbimet sociale** që do t'u ndahen komunave. Kjo formulë mund të bëhet pjesë e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Po ashtu duhet të konsiderohet përgatitja e direktivave dhe udhëzimeve për komunat për zbatimin e formulës së re të grantit për shërbimet sociale<sup>24</sup>.

---

<sup>22</sup> Ligji i Kosovës 05 / L-036 për kompensimin e viktimave të krimit rregullon të drejtën për kompensim për viktimat e krimeve të dhunshme si dhe të varurit e tyre. Ligji u miratua në 2015 duke renditur krimet e dhunshme që kompensohen nga fondi i kompensimit të viktimave. Krimet që duhet të kompensohen përfshijnë: trafikimin e qenieve njerëzore, përdhunimin, abuzimin seksual të fëmijëve, vrasjen, dhe krimet e dhunës në familje siç përcaktohen në ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Ministria e Drejtësisë, aktualisht është në proces të plotësim/ndryshimit të politikës ekzistuese, lidhur me këtë është hartuar drafti final i koncept dokumentit për kompensimin e viktimave të krimit, i cili tashmë është aprovuar në Qeveri, pastaj konform opsionit të rekomanduar do të fillohet me plotësim/ndryshimin e ligjit aktual për kompensimin e viktimave të krimit.

<sup>23</sup> Raporti Vjetor 2018 i Avokatit të Popullit, faqe 31.

<sup>24</sup> Konteksti ligjor dhe fiskal si dhe kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale në Kosovë “Analizë e situatës”, fq.6

Më tutje, financimi publik për ofrimin e shërbimeve sociale dhe jo vetëm i tyre nga shoqëria civile në emër të autoriteteve është i kufizuar. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale me shoqërinë civile mund të përmirësohet, veçanërisht në lidhje **me përcaktimin dhe ekzekutimin e politikave publike**. Shkalla e zbatimit të legjislacionit thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve, duke përfshirë por duke mos u kufizuar këtu me pakon e ligjeve për të drejtat e njeriut, është kyçe për të siguruar mbrojtjen e një game të gjerë të të drejtave të njeriut dhe lirive qytetare. Mbrojtja e plotë në këto fusha mund të sigurohet vetëm nëse zbatohet korniza gjegjëse ligjore përmes akteve nënligjore, strategjive dhe programeve, si dhe duke themeluar dhe funksionalizuar mekanizma dhe organe të veçanta siç përcaktohen me ligj<sup>25</sup>.

Qeveria e Kosovës, përmes **Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut**, që do të jetë i shoqëruar fillimisht me planin tre vjeçar të veprimit (2021-2023) për zbatimin e tij, do të jetë në funksion të zbatimit të pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut dhe komuniteteve, standardeve ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, bashkëveprimit dhe koordinimit më të mirë institucional, dhe do t'i jep shtytje zgjidhjes së problemeve kyçe me të cilat janë duke u përballur institucionet e Republikës së Kosovës gjatë procesit të zbatimit të ligjeve dhe të drejtave të njeriut.

Zbatimi efektiv i ligjeve dhe politikave në të gjitha fushat dhe sektorët duke përfshirë nivelin qendror (ministritë) dhe nivelin lokal të qeverisjes (komunat), pa dyshim se do të ketë ndikim pozitiv dhe do të ngritë mirëqenien, shkallën e mbrojtjes dhe zbatimin e mirëfilltë të dispozitave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel vendi.

#### **4.1 Efikasiteti i institucioneve në zbatimin e të drejtave të njeriut**

**Korniza Ligjore dhe Politike-** Kosova nuk është anëtare e OKB-së, dhe rrjedhimisht, nuk është në pozitë për të ratifikuar instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Me gjithë njohjen dhe zbatimin direkt që Kushtetuta e Kosovës i ofron disa prej instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut<sup>26</sup>, realizimi i të drejtave të njohura me këto instrumente si dhe të drejtave të njohura me vetë Kushtetutën, mbetet për t'u bërë në të ardhmen, ndërsa kjo çështje paraqet një sfidë në vete, marrë parasysh edhe synimet e Kosovës për integrim në BE. Përkundër avansimit dhe harmonizimit të kornizës ligjore për të drejtat e njeriut me standardet ndërkombëtare, si dhe bazuar në të gjeturat e raporteve të monitorimit për të drejtat e njeriut, rezulton se gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë vazhdon të pengohet nga një numër i konsiderueshëm sfidash që rezultojnë në mos zbatimin adekuat të ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Shumica e këtyre mangësive deri tani mund t'i atribuohet mungesës së vullnetit politik.<sup>27</sup>

**Sfidat aktuale të zbatimit të kornizës ligjore / të politikave** -Sa i përket të drejtave themelore, implementimi i ligjeve dhe strategjive përkatëse shpesh dëmtohet nga resurset joadekuate financiare dhe


<sup>25</sup> Ligji për Barazi Gjinore parashih funksionalizimin e mekanizmave për barazi gjinore, ndërsa Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi përcakton obligimin institucional për themelimin e mekanizmave institucional për mbrojtjen nga diskriminimi në ministri dhe komuna. Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 05.04.2017 me nr. të vendimit 02/140 ka miratuar Rregulloren QRK - Nr. 03/2017 për mekanizmat institucional për mbrojtje nga diskriminimi në Qeveri dhe komuna.

<sup>26</sup> Shih, Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës-Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare.

<sup>27</sup> Një sistem i shfrytëzuar pak: "Gjendja e Kornizës së të Drejtave të Njeriut në Kosovë", fq.14.

të tjera, prioritizimi i dikurshëm i kufizuar politik dhe mungesa e bashkërendimit<sup>28</sup>. Përtej problemeve lidhur me zbatimin e ligjeve, gjithashtu ka mungesë të të dhënave lidhur me zbatimin e të drejtave të njeriut në nivel vendi, në tërë sektorët dhe fushat sociale e ekonomike.

Po ashtu, për aq sa i përket transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve lidhur me realizimin e të drejtës së qytetarëve për qasje në dokumente publike, situata ende nuk është në nivelin e dëshiruar. Edhe pse e drejta e qasjes në dokumente publike është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe Ligjin për Qasje në Dokumente Publike<sup>29</sup>, respektimi i kësaj të drejte, si dhe zbatimi i ligjit vazhdon të mbetet sfidues. Qasja e lirë në dokumentet publike jo vetëm që është një e drejtë themelore në çdo shoqëri demokratike, por gjithashtu është edhe një instrument për të garantuar besimin publik ndaj institucioneve, proceseve të drejta vendimmarrëse dhe llogaridhënien e zyrtarëve publikë. Shumica e ankesave të pranuar në IAP gjatë vitit 2018, lidhur me qasjen në dokumente publike, janë kryesisht kundër institucioneve publike në nivel qendror (figura 1 më poshtë).



Përderisa në vitin 2018 ishin paraqitur 61 ankesa, prej të cilave 56 ishin hapur për hetim, në vitin 2019 janë paraqitur 106 ankesa, prej të cilave 99 janë hapur për hetim<sup>30</sup>. Shumica e ankesave të pranuar nga Avokati i Popullit gjatë vitit raportues, lidhur me qasjen në dokumente publike, janë kundër institucioneve publike në nivel qendror duke kapur kështu shifrën prej 43%, për dallim nga viti 2018 ku përqindja ishte 23,41%. Edhe pse është punuar në ngritje të vetëdijesimit të qytetarëve për këtë të drejtë, institucioneve përgjegjëse u mbetet ende për të punuar në promovimin e kësaj të drejte, e cila ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve shtetërore dhe përmirësimin e besimit të qytetarëve në punën e tyre<sup>31</sup>.

Me qëllim të tejkalimit të sfidave të evidentuara, Qeveria e Kosovës do t'i japë prioritet më të lartë politik mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe atyre themelore, si dhe të sigurojë resurset dhe kapacitetet adekuate buxhetore për zbatimin dhe promovimin e tyre, duke përfshirë shërbimet kyqe dhe ndihmën për grupet e cenuseshme. Një vëmendje e shtuar do t'i kushtohet bashkëpunimit dhe koordinimit institucional, fuqizimit të mekanizmave për të drejtat e njeriut, avancimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit për të drejtat e

<sup>28</sup> Shih , Raporti i Vendit për Kosovën 2018, fq.14.

<sup>29</sup> Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokument publike.

<sup>30</sup> Raporti Vjetor 2019 i Avokatit të Popullit, faqe 45.

<sup>31</sup> Raporti Vjetor 2018 i Avokatit të Popullit fq.40.

njeriut në nivel vendi, avancimit të barazisë gjinore përmes mekanizmave ligjorë dhe institucionalë, si dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve karshi kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente publike.

#### 4.2 Qasja në sistemin e drejtësisë

Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm (SDG), bëjnë thirrje për promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimin e qasjes në drejtësi për të gjithë, formimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Këtyre aspiratave iu bashkohet Qeveria e Kosovës duke e vënë një theks të veçantë mbi këto tema edhe në Planin Qeverisës.

Nga pikëpamja institucionale, përveç organeve të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, **pushteti gjyqësor** ka rol signifikant në garantimin e sigurisë juridike të qytetarëve. Respektimi i procedurave dhe afateve ligjore, respektimi i gjykimit të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor, dhënia e vendimeve të plota e të bazuara në ligj, zbatimi me kohë dhe me korrektësi i vendimeve të dhëna nga gjykatat etj, ndikojnë fuqishëm në fitimin e besimit dhe krijimin e sigurisë juridike të qytetarëve. Gjyqësori i vendit, përkundër reformës ligjore e organizative nuk ka arritur të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare<sup>32</sup>, në veçanti Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Gjykatat, me rastin e vendosjes së çështjeve, rrallë ose fare nuk i referohen praktikës së GJEDNJ-së, dhe në rastet kur kjo ndodh ato janë të përgjithësuara dhe jo konkrete në raport me rrethanat e rastit në praktikë. Vlen të ritheksohet që sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat e njeriut interpretohen në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së<sup>33</sup>.

Në anën tjetër, vetëm 27% e të gjithë gjyqtarëve në Kosovë janë gra (**94 nga 352 gjyqtarë gjithsej**)<sup>34</sup>. Trajnimi për çështje gjinore ende nuk është institucionalizuar për gjyqtarët. Gjykatat nuk mbajnë të dhënat elektronike të zbërthyer sipas gjinisë, gjë që kontribuon në sfidat në monitorimin e çdo paragjykimi të mundshëm gjinor që mund të ekzistojë në procedimin dhe dënimin e rasteve.<sup>35</sup> Mungesa e sistemit informatik ndër-institucional për të dhëna dhe menaxhim të lëndëve që do të përfshinte të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë, e bën të vështirë përcjelljen e çështjeve që kanë të bëjnë me gjininë.

---

<sup>32</sup> Sa i përket mbrojtës së të drejtave të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare, në veçanti Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 30 gusht 2016, ka miratuar Rregulloren 11/2016 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, që i referohet kriterëve të vlerësimit, e cila është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.01/2019, të datës 24.01.2019. Kjo rregullore (nr.01/2019), në nenin 4 parasheh që kriteri i përcaktuar në nenin 12, par.1, nën-par.1.1, të rregullores bazike, ku ndër të tjerash flitet për kapacitetin e gjyqtarëve për arsyetime ligjore, matet sipas treguesve si në vijim:

1.3 zbatimi i standardeve ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut gjatë procedurës gjyqësore si dhe në kuadër të vendimeve gjyqësore, si dhe 1.4 zbatimi i standardeve juridike ndërkombëtare (GJEDNJ) dhe konventa të tjera ndërkombëtare.

<sup>33</sup> Raporti I Avokatit të Popullit 2016 fq.21.

<sup>34</sup> Korrespondencë e RRGK-së me Forumin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të Kosovës, 2017.

<sup>35</sup> Analiza Gjinore e Rrjetit të Grave të Kosovës- <https://ëomensnetëork.org/ëp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>



Problem në vete paraqet Zvarritja e procedurave gjyqësore- Në Kosovë, gjykatave u duhet kohë shumë e gjatë për të zgjidhur rastet. Kjo e rritë koston e proceseve si dhe i dekurajon qytetarët dhe bizneset që të parashtrajnë raste për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre<sup>36</sup>. Një gjë e këtillë në veçanti ndikon në uljen e numrit të investitorëve të huaj. Zvarritjet e procedurave në vendosjen e lëndëve gjyqësore, mungesa e mjeteve efektive juridike, shkalla e ulët e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të plotfuqishme, janë çështje që kërkojnë vëmendje dhe adresim adekuat nga autoritetet përkatëse<sup>37</sup>. Gjithsesi zvarritjet në procedimin e rasteve gjyqësore shkelin të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt brenda afatit të arsyeshëm kohor, të drejtën për mjete efektive juridike dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>38</sup>. Vetëm gjatë vitit 2017, rreth 26% të ankesave të paraqitura në IAP kanë të bëjnë me pretendimet për zvarritjen e procedurave gjyqësore. Gjithashtu, në bazë të numrit të ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit raportues 2019, qytetarët vazhdojnë të përballen me zvarritje të procedurave për vendosjen e rasteve të tyre me vite të tëra si dhe mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të plotfuqishme, të cilat ndikojnë në pamundësinë e realizimit të të drejtave të tyre<sup>39</sup>. Situatës së rëndë lidhur me procedurat e stërzgjatura nëpër gjykata, i kontribuon edhe mungesa e një mekanizmi të brendshëm ligjor nëpërmes të cilit qytetarëve, të cilëve u është shkelur e drejta në një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, **do të mund të kërkonin kompensim për shkak të shkeljes së kësaj të drejte**<sup>40</sup>.

*Këshilli Gjyqësor i Kosovës* në raportin statistikor të gjykatave të gjashtëmujorit të parë të vitit 2016, ka raportuar se numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura është 417,733<sup>41</sup>. Sipas këtij Raporti, gjykatat kanë pasur në punë gjithsej 664,465 lëndë gjyqësore, ndërsa kanë zgjidhur 246,700.

Në raportin e fundit të publikuar për 9 mujorin e parë të vitit 2019, rezulton se ka progres në numrin e lëndëve të pazgjidhura. Kështu për shembull, Raporti i departamentit të përgjithshëm të gjykatave themelore të Kosovës, ku janë të vendosura lëndët sipas natyrës së veprës, rezulton se deri me datën 01.01.2019 janë trashëguar 40,118 lëndë, të pranuar janë 14,425 lëndë, të zgjidhura janë 20,927 lëndë dhe të pazgjidhura janë 33,605 lëndë, që nënkupton se efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve nga gjyqtarët është 145 %, pra më shumë lëndë të zgjidhura se të pranuar. Sidoqoftë, ky nuk është rasti gjithmonë. Marrë këtë parasysh, gjyqësori duhet të ndërmerri hapa adekuatë në rritjen e efikasitetit dhe zgjidhjes me kohë të

<sup>36</sup> Shih „Strategjia Kombëtare për Zhvillim Kombëtar 2016-2021 (SKZH), fq.7.

<sup>37</sup> Avokati i Popullit, në raportin e punës për vitin 2018, sa i përket mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të qytetarëve, rithekson kërkesën për zbatimin e rekomandimit, Ex officio.nr.129/2019, Raport me rekomandime për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë, Lidhur me nevojën e krijimit të një mekanizmi ligjor të brendshëm, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, i cili qytetarëve do t'ua garantonte të drejtën në mjete efektive juridike në rastet e shkeljes të së drejtës në zgjidhjen e rasteve të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe mosekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, të drejta këto të përcaktuara me nenin 6 të KEDNJ-së dhe të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

<sup>38</sup> Raporti Vjetor 2019 i Avokatit të Popullit, fq.28.

<sup>39</sup> Raporti Vjetor 2019 i Avokatit të Popullit, fq.25.

<sup>40</sup> Në ato raste specifike në të cilat për shkak të zvarritjes, paraqitet shkelje e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, rekomandon: (a) që procedura të përshpejtohet, ose b) që kompensim tu jepet viktimave për çdo disavantazh që mund të kishin vuajtur ose (c) që të ndërmerren të dyja këto zgjidhje, Theksohet se opsioni i fundit është ai me i preferuari (po aty.Rekomandimi Nr.7).

<sup>41</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës- Raporti i 6-mujorit të parë 2016, Statistikat e gjykatave të rregullta, www.kgjk-ks.org, faqe 3.

lëndëve, në qëllim të respektimit të së drejtës në gjykim të drejtë dhe rritjen e përgjithshme të efikasitetit dhe eficiencës brenda sistemit gjyqësor.

Problem në vete, paraqet **parashkrimi i lëndëve në gjykata dhe prokurori**- është shqetësues numri i lëndëve të qytetarëve që parashkruhen në gjykata dhe prokurori, gjë që dëmton seriozisht besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe shkelë të drejtat e njeriut. Parashkrimi i lëndëve mund të jetë rezultat i ngarkimit të gjykatave me lëndë gjyqësore dhe pamundësisë së vendosjes brenda afateve kohore. Po ashtu, ka raste kur parashkrimi vjen si pasojë e neglizhencës apo e keqpërdorimeve. Institucionet kompetente<sup>42</sup>, në të gjitha rastet e parashkrimit të lëndëve gjyqësore, duhet të hetojnë në hollësi shkaqet e parashkrimit të lëndëve për çdo rast pa asnjë përjashtim dhe të iniciojnë procedura përkatëse ndaj përgjegjësve që kanë lejuar parashkrimin e lëndëve gjyqësore<sup>43</sup>.

Gjithashtu, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në nivel të vendit mbetet ende i ulët. Raporti gjashtë mujor i vitit 2016 i KGJK-së, sa i përket lëndëve civile, tregon se gjykatat kanë pasur në punë 3,179 lëndë, prej të cilave i kanë ekzekutuar 880, ndërsa 2,299 kanë mbetur pa u ekzekutuar<sup>44</sup>.

Përveç lëndëve të grumbulluara, ka një numër të madh vendimesh të pa ekzekutuara të gjykatës (rreth 117,000 në shtator të vitit 2017). Që gjërat të përkeqësohen edhe më tej në këtë drejtim, ndikojnë edhe probleme të tjera që janë pasojë e drejtpërdrejtë e kulturës juridike në Kosovë<sup>45</sup>.

Një çështje tjetër, e cila e pengon realizimin e plotë të së drejtës për mbrojtje gjyqësore efektive, ka të bëjë edhe me mos përfaqësimin adekuat të palëve nga ana e avokatëve mbrojtës në çështje të ndryshme gjyqësore. Ndihma juridike falas është kategori kushtetuese që u vihet në dispozicion qytetarëve që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, për hir të përfaqësimit të interesave ligjore në procedurë.

Ndonëse modalitetet për ndihmë juridike falas janë përmirësuar në vitet e fundit, më se 50% e popullsisë në Kosovë ende nuk është në dijeni të ekzistimit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas. Po ashtu, si sfidë për ofrimin e ndihmës juridike falas në raport me kërkesat e qytetarëve mbetet mungesa e mjeteve buxhetore, gjë që e pamundëson ofrimin e ndihmës juridike për qytetarët në tërë territorin e Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin<sup>46</sup>.

Me qëllim që të sigurohet qasja e barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët, Agjencia duhet të sigurojë shtrirjen e ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës, sepse pa qasje në ndihmë juridike falas dhe pa qasje të barabartë në drejtësi, mbeten edhe 17 komuna të tjera me gjithsej 481,797 banorë të pambuluar. Tutje, Qeveria përtej çdo dyshimi, do të punojë në sigurimin e resurseve të mjaftueshme për të mbështetur funksionimin e zyrave të ndihmës juridike dhe të mbështesë zhvillimin e politikave që u mundësojnë grupeve tjera të ndjeshme të kenë qasje në ndihmë juridike, duke përfshirë gratë që pësojnë dhunë në baza gjinore, të cilat nuk mund të angazhojnë ndihmë juridike me pagesë.

---

<sup>42</sup> Në janar të vitit 2019 ka hyrë në fuqi Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve( me tutje Ligji Nr.06/L057), i cili ka paraparë një procedurë komplet ndryshe për disiplinimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Pas kalimit të periudhës tranzitore, Zyra e Prokurorit Disiplinor është shuar dhe personeli i saj është bartur në KGJK dhe KPK.

<sup>43</sup> Raporti i Avokatit të popullit 2016, fq.21.

<sup>44</sup> Po aty fq.24.

<sup>45</sup> Një sistem i shfrytëzuar pak, Gjendja e Kornizës së të drejtave të njeriut në Kosovë, fq.12.

<sup>46</sup> Raporti vjetor 2015 i Agjencisë për ndihmë juridike falas.

**Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave (ZMNV)**<sup>47</sup>, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeprokuroorit të Shtetit, ka mandat që të institucionalizojë të drejtat e viktimave të krimit dhe t'u ofrojë atyre përfaqësim, këshillim dhe përkrahje për të pasur qasje në sistemin e drejtësisë. Seksioni ofron ndihmë juridike falas për viktimat e të gjitha krimeve, me fokus të veçantë në viktimat e dhunës në familje, trafikimit të personave, abuzimit të fëmijëve dhe dhunës<sup>48</sup>. Brenda Divizionit për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave ekziston edhe Linja Ndhimëse për viktimat e krimit e cila ofron informata mbi shërbimet e disponueshme dhe kontaktet përkatëse, si dhe për referimin, e shërben si mjet për identifikimin e viktimave potenciale të krimit. Kategoria e banorëve të përhershëm (lindje të paregjistruara), që nuk mund të provojnë nënshtetësinë e Kosovës, duhet të përfshihen në sistemin e ndihmës juridike falas (aktualisht UNHCR-ja ofron ndihmë juridike për marrjen e shtetësisë).

**Funksionimi i sistemit të ndërmjetësimit-** Ndërmjetësimi ka qenë në funksion që nga viti 2008. Vetëdija publike apo njohuritë për mjetet e **zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve** mbeten të dobëta, por numri i rasteve të referuara dhe të zgjidhura përmes ndërmjetësimit është në rritje e sipër. Një gjë e këtillë në veçanti është theksuar gjatë kohës së përhapjes së pandemisë Covid-19 në Kosovë.

Në vitin 2018, është miratuar Ligji i ri për Ndërmjetësimin i cili ka për qëllim të heq pengesat ndaj zbatimit të këtij mekanizmi si dhe të prezantojë procedurën e ndërmjetësimit të detyrueshëm. Ndërmjetësimi i detyrueshëm nënkupton referimin e detyrueshëm në ndërmjetësim për lëndët e natyrave të caktuara, qoftë nga gjyqtari apo përmes vetë inicimit nga qytetari, përmes procedurës për vetë incimin e lëndëve, të paraparë për herë të parë përmes Ligjit të ri për Ndërmjetësimin të vitit 2018.

Kjo risi dhe risitë e tjera të sjellura me këtë Ligj, pritet të shërbejnë për qëllimin e përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarët në fushën e drejtësisë. Nëse ndërmjetësimi funksionalizohet në fushat e cekura ligjore, atëherë kjo metodë për zgjidhjen e kontesteve me siguri do të ketë një kontribut domethënës në lehtësimin e ngarkesës së punës në gjykata. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë është në përfundim e sipër të hartimit të akteve nënligjore që burojnë nga Ligji për Ndërmjetësimin.

**Kushtet e burgjeve dhe të drejtat e të burgosurve-** Kushtet e burgjeve dhe të qendrave të paraburgimit në përgjithësi i plotësojnë standardet ndërkombëtare, por ka probleme të konsiderueshme në mjediset e mangëta fizike<sup>49</sup>, korrupsioni<sup>50</sup> si dhe kujdesi mjekësor nën standard<sup>51</sup>.

Gjithashtu, vëmendje e shtuar duhet t'u kushtohet të drejtave të personave të paraburgosur, të cilët në mungesë të provave apo dëshmitarëve të tjerë, mbahen gjatë në paraburgim. Ka raste kur i paraburgosuri është mbajtur me këtë status deri në 6-të vite.

---

<sup>47</sup> Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave (ZMNV), vepron si zyrë qendrore në Prishtinë, si dhe ka shtatë zyre të vendosura në kuadër të Prokurorive themelore si zyre regjionale.

<sup>48</sup> Shih, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën 2017, fq. 11.

<sup>49</sup> Me hapjen e qendrave të paraburgimit në Prishtinë dhe Gjilan, janë krijuar hapësira për sistemim dhe për klasifikimin e të dënuarve, si dhe janë krijuar hapësira të mjaftueshme për të gjitha kategoritë e madhorëve.

<sup>50</sup> Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka krijuar edhe mekanizma të rinj për evidentimin, hulumtimin dhe ndëshkimin e kësaj dukurie.

<sup>51</sup> Shih, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën 2017, fq. 6.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), vlerëson se objektet dhe trajtimi i të burgosurve me aftësi të kufizuara mbeten nën standardet ndërkombëtare. Edhe pse Ligji kërkon që personat e dënuar, me probleme të dokumentuara të shëndetit mendor, të mbahen në objekte të dedikuara për kujdes të shëndetit mendor, këta të burgosur shpesh vendosen në burgje standarde për shkak të mbingarkesës në institucionet e shëndetit mendor<sup>52</sup>.

*Nuk ka dispozita ligjore apo udhëzime administrative për trajtimin e të burgosurve me aftësi të kufizuara, ndërsa një legjislacion i tillë është i domosdoshëm për të plotësuar standardet ndërkombëtare për burgjet dhe qendrat e paraburgimit, në pajtim me konventat ndërkombëtare për mbrojtjen dhe të drejtat e të burgosurve.*

Autoritetet kompetente të administratës nuk zhvillojnë gjithmonë hetime të duhura për keqtrajtime.<sup>53</sup> Për shkak të trajnimit të dobët dhe personelit joadekuat, autoritetet nuk kanë ushtruar gjithmonë kontroll mbi objektet ose të burgosurit. QKRMT ka vlerësuar se drogat e paligjshme janë kontrabanduar rregullisht në mjediset korrektuese, me rreth 30 për qind të të burgosurve që vlerësohet të jenë të varur nga droga. Po ashtu, nuk kishte programe të trajtimit të drogës<sup>54</sup>, e ka pak profesionistë të trajnuar që punojnë me të burgosurit (veçanërisht mjekë, infermierë, psikologë dhe psikiatër).

**Qasja në drejtësi për pjesëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë**- veçanërisht për serbët e Kosovës dhe personat e zhvendosur, mbetet shqetësim. Përkthimi i dobët në procedurat para gjykatave, një numër i rasteve të pazgjydhura, moszbatimi i vendimeve, numri i kufizuar i stafit joshqiptar, mospërputhja në mes të përkthimeve në gjuhën shqipe dhe serbe të legjislacionit dhe mungesa e sistemit funksional të gjyqësorit në veri të Kosovës pengoi ushtrimin e drejtësisë<sup>55</sup>. Komisioni Këshilldhënës për konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, po ashtu nënvizon pengesat e vazhdueshme në arritjen e qasjes së barabartë në drejtësi mes komunitetit shqiptar dhe atij joshqiptar, në mes të tjerash edhe për shkak të zbatimit të pjesshëm të legjislacionit për gjuhët lidhur me procedurat gjyqësore dhe ekzistimit të ndihmës juridike falas, e cila posaçërisht në gjuhën serbe, plotësisht varet nga donatorët dhe është bërë e parregullt<sup>56</sup>. Ftesat në gjykata për personat e zhvendosur, të cilët kurrë nuk i arrijnë ato, vazhdojnë të jenë një problem për shkak të mungesës së mekanizmave. Një gjë e tillë shpie në vendime të padrejta, veçanërisht në lidhje me kthimin e pronës<sup>57</sup>. Sa u përket çështjeve të sigurisë, situata e përgjithshme e sigurisë për komunitetet jo shumicë mbetet relativisht e qëndrueshme. Sidoqoftë, incidentet që prekin të

---

<sup>52</sup> ([https://xk.usembassy.gov/ep-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2018\\_Alb.pdf](https://xk.usembassy.gov/ep-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2018_Alb.pdf))

<sup>53</sup> Sipas gjetjeve të QKRMT-së, Mekanizmi i brendshëm për ankesa, i paraparë me ligj, nuk funksiononte, pasi të burgosurit shpesh nuk i lajmëronin abuzimet për shkak të mungesës së konfidencialitetit dhe frikës nga hakmarrja. QKRMT-ja gjithashtu vuri në pah se autoritetet nuk ofronin vendime me shkrim me të cilat arsyetohej izolimi në vetmi. Prandaj, funksionalizimi i mekanizmave të brendshëm për ankesa dhe monitorimi adekuat i keqtrajtimit duhet të jenë primar sa i përket administratës së burgjeve dhe qendrave të paraburgimit.

<sup>54</sup> Country Reports on Human Rights Practices for 2018 United States Department of State • Bureau of Democracy, Human Rights and Labor, fq.4.

<sup>55</sup> Shih, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën 2017, fq.28.

<sup>56</sup> Shih, Opinioni i katërt për Kosovën I miratuar më 8 mars 2017, nga Komisioni këshilldhënës i konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, fq.15.

<sup>57</sup> Koment nga UNHCR.

kthyerit ndikojnë në përceptimin e personave të zhvendosur, duke rezultuar në ngurrim dhe më pak interesim për t'u kthyer.

**Kthimi i pronës dhe realizimi i të drejtave pronësore-** Një varg problemesh lidhur me çështjet pronësore janë identifikuar në Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë (SKDP). Kjo Strategji<sup>58</sup> vë në pah se *legjislacioni i paqartë, i cili rregullon të drejtat mbi pronën e paluajtshme, shkalla e gjerë e informalitetit në sektorin e pronave dhe zbatimin jo-konsistent i të drejtave pronësore ndikon në të drejtat e njeriut, dobëson gjendjen e komuniteteve të marginalizuara dhe pengon rritjen ekonomike*<sup>59</sup>.

Avokati i Popullit e vlerëson aprovimin e SKDP dhe përkushtimin e autoriteteve e ministrive përkatëse për zotimin se mangësitë lidhur me çështjet pronësore do të adresohen dhe se do punohet në fuqizimin e ngritjen e sigurisë juridike në të drejtat pronësore për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) një organ kuazi-gjyqësor, ka vështirësi në zbatimin e vendimeve të saj. Deri në muajin gusht, Agjencia paraqiti 416 kallëzime penale në Prokurori kundër banorëve të paligjshëm të cilët ri-okupuan prona pas dëbimeve të AKKVP-së; 460 mandate për dëbim mbetën të pazgjidhura gjatë kësaj periudhe. Zona e vendit me proporcionin më të lartë të dëbimeve në pritje ishte Mitrovica me 337, duke prekur kryesisht shqiptarët e Kosovës<sup>60</sup>.

### **Të drejtat pronësore të personave të zhvendosur dhe pjestarëve të komuniteteve që nuk janë shumicë**

Njerëzit e zhvendosur për shkak të luftës, kanë të drejtë të kthehen në shtëpitë dhe pronat e tyre të paluajtshme, e drejtë kjo universale dhe e njohur nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj. Pas miratimit të "Parimeve mbi rikthimin e banimit dhe pronës për refugjatët dhe personat e zhvendosur", të njohur edhe si "Parimet Pinheiro", koncepti i kthimit, ashtu si e ka definuar bashkësia ndërkombëtare, ka nënkuptuar "jo vetëm kthimin në shtetin amë të refugjatit ose në qytetin apo rajonin e personit të zhvendosur, por kthimin dhe rivendosjen e kontrollit mbi shtëpinë origjinale, tokën ose pronën; procesi i rikthimit të banimit dhe pronës. Zgjidhja përfundimtare e kërkesave të suksesshme të vendosura nga AKKVP-ja, është intervenimi parësor për fuqizimin dhe garantimin e të drejtave pronësore të komuniteteve jo shumicë të vendit.

Zotimi i Qeverisë së Kosovës për sigurimin e të gjithë personave të zhvendosur<sup>61</sup> me mjete juridike përfundimtare, të drejta efektive që do t'ju mundësojë atyre rivendosjen e kontrollit mbi pronat e paluajtshme që ju takojnë, është cekur edhe në preambulën e nenit 4 të Marrëveshjes për Stabilizim dhe

<sup>58</sup> Me qëllim sigurimin e të drejtave pronësore për të gjithë kosovarët, SKDP i ka parasysh sfidat me të cilat ballafaqohen gratë, personat e zhvendosur dhe pjesëtarët e komuniteteve Jo shumicë në realizimin e plotë të drejtave të tyre pronësore dhe, rrjedhimisht, propozon rekomandime specifike që duhet të ndërmerren me qëllim të adresimit të këtyre sfidave.

<sup>59</sup> Pakoja ligjore (1.LIGJI Nr. 06/L-007 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-007 PËR PROCEDURËN JOKONTËSTIMORE, GZ Nr. 22 /18 DHJETOR 2018; 2. LIGJI Nr. 06/L-008 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/26 PËR TRASHËGIMINË NË KOSOVË, GZ, Nr. 22 / 18 DHJETOR 2018; dhe 3. LIGJI Nr. 06/L-010 PËR NOTERINË, GZ. Nr. 23 /26 DHJETOR 2018) ka adresuar rekomandimet që ndërlidhen me SKDP-në, përkatësisht me këto ndryshime ligjore është forcuar roli i gruas në trashëgimi, duke siguruar që në rast të heqjes dorë nga trashëgimia, organi vendimmarrës (gjykata apo noteri) të sigurohet që kjo heqje dorë është bërë në pajtim me vullnetin e lirë të tyre.

<sup>60</sup> Shih, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën 2017, fq. 12.

<sup>61</sup> UNHCR vlerëson se 423 persona të zhvendosur brenda Kosovës jetojnë në strehimore kolektive në kushte nën standard, shih, Office of the Chief of Mission Pristina, Kosovo, Statistical Overview January 2019.

Asociim të lidhur në mes të Kosovës dhe BE-së<sup>62</sup>. Në përputhje me Raportin e Vendit për Kosovën për vitin 2018, moszgjidhja e kërkesave pronësore nga personat e zhvendosur është një faktor i rëndësishëm që shpjegon pse nuk ka mjedis të përshtatshëm për kthimin. Sa i përket të **drejtave të pronësisë**, megjithëse korniza legislative dhe institucionale që rregullon zgjidhjen e pretendimeve pronësore të lidhura me konfliktin është përgjithësisht adekuate, periudha e raportimit nuk ka shënuar progres real në zbatimin e strategjisë së vitit 2017 për të drejtat e pronësisë<sup>63</sup>.

Qeveria e Kosovës, në janar të vitit 2018, miratoi Rregulloren për kthim të personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme. Rregullorja paraqet hap të rëndësishëm në përkushtimin e Qeverisë ndaj këtij procesi dhe konsolidimin e procedurave ndërmjet mekanizmave të ndryshëm institucionalë që janë aktiv në procesin e kthimit, duke e vendosur Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) qartazi në krye të këtij bashkërendimi. Rregullorja ka shfuqizuar mekanizmat e vjetër bazuar në kornizën e politikave dhe për herë të parë në 19 vite ka themeluar një kornizë obligative për procesin e kthimit. Tani nevojiten përpjekje për ta zbatuar në mënyrë të duhur këtë Rregullore. Po ashtu, Agjencia për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronave të Kosovës dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, duhet të përmirësojnë bashkëpunimin e tyre për të lehtësuar kthimin e pronave dhe procesin e kthimit. Vendimet gjyqësore, përfshirë vendimet e Gjykatës Kushtetuese mbi rastet e pronësisë të lidhura me konfliktin, duhet të respektohen plotësisht dhe të zbatohen me shpejtësi.<sup>64</sup>

#### **4.3 Mbrojtja sociale dhe shëndetësore**

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK), vazhdon ende të jetë jashtë listës së instrumenteve ligjore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë. Kosova mbetet ndër vendet e vetme në Evropë që nuk është pjesë e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore.<sup>65</sup> Kjo është ndër të metat themelore të sistemit tonë kushtetues në fushën e të drejtave të njeriut, edhe pse Kushtetuta njeh një sërë të drejtash ekonomike, sociale dhe kulturore.

Kosova është një nga vendet më të varfra në Evropë, sipas raportit “Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës” të publikuar në muajin prill 2017, nga Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës: 17.6 përqind e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me më pak se 1.82 euro në ditë, ndërsa 5.2 përqind e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë së skajshme, me më pak se 1.30 euro në ditë. Krahasuar me vitet paraprake kemi një rënie të nivelit të varfërisë. Niveli i varfërisë mbetet i lartë sidomos për grupe siç janë: familjet që banojnë në vendbanimet rurale, familjet me më shumë anëtarë, ku shkalla më e lartë e varfërisë është gjetur tek familjet me shtatë e më shumë anëtarë, familjet që burim kryesor të të ardhurave kanë ndihmën sociale, familjet që burim kryesor të të ardhurave kanë pensionet, personat me

---

<sup>62</sup> Shih, Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore, fq.31.

<sup>63</sup> Shih, Raportin për vendin të Komisionit Evropian 2020.

<sup>64</sup> Shih, Raportin për vendin të Komisionit Evropian 2020.

<sup>65</sup> Sigurimi shëndetësor në Kosovë: një e drejtë e vonuar, fq.59.

aftësi të kufizuara, të papunësuarit, familjet që kryesohen nga gratë, individët me shkallë të ulët të arsimimit, si dhe qytetarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë.

Bazuar në ankesat e pranuar në IAP<sup>66</sup> si dhe nga vizitat e realizuara në terren, rezultojnë se ndër faktorët kryesorë që janë duke ndikuar në jetën e rënduar ekonomike dhe sociale në Kosovë është **papunësia** si faktor kyq. Sidomos është brengosëse shkalla e papunësisë tek gratë dhe të rinjtë e moshës (15-24 vjeç).

**Tab. 1: Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)**

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)	Burra	Gra	Gjithsej
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	57,1	20,3	38,8
Shkalla e joaktivitetit	42,0	79,7	61,2
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	44,0	14,1	29,1
Shkalla e papunësisë	23,0	30,6	25,0
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	42,9	53,6	<b>46,4</b>
Përqindja e të rinjëve NEET në popullsinë e të rinjve (15-24 vjeç)	29,0	29,1	29,0
Përqindja e punësimit të paqëndrueshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	18,1	11,2	16,5

**Burimi: Anketa e Fuqisë Punëtore, TM1 2020**

Nga e gjithë popullsia e Kosovës në moshë pune, 29.1 % ishin të punësuar. Gjithashtu është brengosëse shkalla e punësimit sipas gjinisë. Kjo e fundit është më e lartë për burra se sa për gra: 44.0 % të meshkujve në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 14.1 % të grave po ashtu në moshë pune<sup>67</sup>. Një faktor kyq që kontribuon në pjesëmarrjen e ulët të grave në fuqinë punëtore është përgjegjësia e ofrimit të kujdesit, kryesisht kujdesi për fëmijët: 32% e grave thonë se kjo pengon punësimin e tyre. Vetëm 1% e burrave ia atribuojnë pasivitetin përgjegjësive të ofrimit të kujdesit. Burrat janë të prirë të jenë joaktivë për shkak të vijimit të shkollës, arsimit ose trajnimit (37%). Dispozitat për pushimin prindëror në Ligjin e punës duhet të ndryshohen, pasi çekuilibri aktual gjinor paraqet pengesë për punësimin e grave.<sup>68</sup>

Përtej problemeve në fushën e punësimit, referuar në rastet e pranuar në IAP, gjendja ekonomiko-sociale në vend mbetet sfidë dhe shqetësim, këto probleme duhet adresuar me prioritet nga institucionet kompetente. Për më tepër, kushtet e përcaktuara për ndihmë sociale me dispozitat ligjore në fuqi kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes ekonomike të shumë familjeve, duke shkaktuar edhe pengesa dhe vështirësi në rritjen adekuate të fëmijëve dhe mirëqenien e familjeve në përgjithësi.

<sup>66</sup> Në IAP, nga kategoria Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale, janë pranuar gjithsej 374 ankesa, prej tyre 108 janë hapur për hetim.

<sup>67</sup> Agjencioni i Statistikave të Kosovës-Anketa e Fuqisë Punëtore TM1 – 2020.

<sup>68</sup> Kosovo Womens Network, *Kosovo Gender Analysis*, 2018.

**Mirëqenia Sociale** - në vazhdimësi është përcjellë nga një pamjaftueshmëri e buxhetit sa i përket financimit aktual të ndarë nga Qeveria dhe komunat për të garantuar cilësi adekuate të shërbimeve sociale dhe familjare. Treguesit e skemës së ndihmës sociale konsiderohet se nuk janë të përcaktuar në bazë të nevojave për ta ulur varfërinë. Një gjë të këtillë e dëshmon më së miri kriteri për të përfituar nga skema e ndihmës sociale, e cila përjashton familjet e fëmijëve mbi 5 vjeç që të përfitojnë nga skema e ndihmës sociale, përfshirë edhe fëmijët jetim nga moshën 15-18 vjeç, edhe pse evidencat dëshmojnë se varfëria është më e lartë në mesin e fëmijëve me arritjen e moshës së shkollimit, ku paralelisht rriten edhe nevojat e fëmijëve<sup>69</sup>. Duhet të merret parasysh ndryshimi i Ligjit për Skemat e Ndihmës Sociale, për të eliminuar ose modifikuar këtë kërkesë, në mënyrë që e drejta për ndihmë të jetë e bazuar drejtpërdrejt në nevojë<sup>70</sup>. Gjithashtu, problem në vete paraqet edhe mungesa e informimit të qytetarëve se ku mund të marrin shërbime dhe çfarë lloje të shërbimeve sociale dhe familjare ofrohen nga ana e institucioneve kompetente. Përkrahja sociale në Kosovë është e orientuar kryesisht në ofrimin e ndihmës monetare mujore për familjet e varfra, personat me aftësi të kufizuara, pensionistët dhe për kategoritë e invalidëve të luftës e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, duke përfshirë së fundmi edhe viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Megjithatë skemat sociale marrin rreth 6% të PBB-së në Kosovë, më pak se 0.5% u shkon atyre që kanë nevojë.

**Mbrojtja shëndetësore**- Kushtetuta e Kosovës garanton të drejtën në mbrojtje sociale dhe shëndetësore, që realizohet përmes pensioneve dhe asistencës sociale, ndërsa sigurimi shëndetësor ende nuk është bërë pjesë e kësaj mbrojtjeje. Si rrjedhojë, 98% e popullatës së Kosovës nuk gëzon sigurim shëndetësor, duke përjashtuar këtu 2% që këtë e bëjnë nëpër kompanitë private që ofrojnë shërbime të tilla<sup>71</sup>.

Shpenzimet e ulëta publike në shëndetësi mbesin brengosëse. Më 2016, u vlerësua që vetëm 40% të nevojave të përgjithshme vjetore për shëndetësi publike mbulohen. Fondet e alokuara kryesisht shpenzohen për të mbuluar kosto fikse (rreth 68%), duke lënë vetëm rreth 32% për kosto direkte të pacientëve, lidhur me diagnostikimin, trajtimin dhe parandalimin.<sup>72</sup>

Sa i përket aspekteve të mbrojtjes shëndetësore, edhe pse Ligji për Sigurimin Shëndetësor, i cili ka për qëllim sigurimin e qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në shërbime kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, megjithatë është aprovuar në vitin 2014 deri më sot ende nuk është zbatuar. Ende nuk është funksionalizuar “**Fondi i Sigurimeve Shëndetësore**”, i cili do të fillonte me mbledhjen e fondeve për të njëjtin. Moszbatimi i këtij Ligji po ndikon drejtpërdrejt tek qytetarët me mungesat e kushteve të përshtatshme të shërbimeve mjekësore. Qeveria e Kosovës do të japë prioritet dhe do të ndërmarrë veprime, të cilat do të mundësojnë zbatimin e Ligjit për Sigurimin shëndetësor.

Qasja në kujdesin shëndetësor mund të dallojë për gratë dhe burrat, duke përfshirë edhe ndryshimet në bazë të përkatësisë etnike dhe vendndodhjes gjeografike. Ekzistojnë dallime në shfrytëzimin e shërbimeve

---

<sup>69</sup> Karta raportuese për të drejtat e fëmijëve, fq.37.

<sup>70</sup> Po aty, fq.63.

<sup>71</sup> Sigurimi shëndetësor në Kosovë: një e drejtë e vonuar, fq.61.

<sup>72</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2018, fq.62.



shëndetësore në bazë të përkatësisë etnike dhe gjinisë. Serbët dhe goranët kanë tendencë të shfrytëzojnë shumicën e shërbimeve, ndërsa shqiptarët dhe boshnjakët i shfrytëzojnë më së paku. Burrat goranë shfrytëzojnë më shumë shërbime sesa gratë gorane. Gratë shqiptare dhe turke shfrytëzojnë më shumë shërbime sesa burrat e të njëjtës përkatësi etnike. Në këtë drejtim, nuk ekzistojnë dallime të konsiderueshme në mes të grave dhe burrave romë, ashkali dhe egjiptianë. Disa nga nënat rome, ashkali dhe egjiptiane lindin në shtëpi, shpesh në kushte josanitare. Si rezultat, shumë fëmijë nuk janë të regjistruar nga shteti. Kjo ndikon në qasjen në kujdesin shëndetësor më vonë në jetë, pasi personat e paregjistruar nuk mund të marrin asistencë sociale ose të kenë qasje në shërbimet shëndetësore publike<sup>73</sup>.

Kosova ende nuk ofron shërbime përkatëse për fëmijët viktime të abuzimit me substanca narkotike dhe familjet e tyre, mirëpo Ministria e Shëndetësisë ka paraparë themelimin e Qendrës për Sëmundjet e Vartësisë që do të ofrojë shërbime të integruara në bashkëpunim me Ministrinë tjetra.

Shërbimet sociale në kuadër të Qendrave për punë sociale (QPS-ve) në nivel komunal trajtojnë këtë kategori me ofrimin e shërbimeve sociale bazike, përfshirë këshillimin, sanimin e marrëdhënieve familjare dhe referimin në institucione tjera përkatëse.

Institucionet kompetente shtetërore duhet të hartojnë programe parandaluese dhe të ofrojë shërbime cilësore për mbrojtjen dhe ndihmën e fëmijëve përdorues të substancave narkotike, në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre. Ministria e Shëndetësisë që nga viti 2012 ka hapur Qendrat e Terapisë Mbajtëse me Metadon ku aktualisht ky program zbatohet në 6 qendra Regjionale dhe në 4 Qendra në Sistemin Shëndetësor të Burgjeve. *Në Kosovë ka mungesë të qendrave të specializuara për trajtimin e përdoruesve të substancave narkotike, e veçanërisht për të rinjtë.* Shërbimet përkatëse të trajtimit, rehabilitimit dhe riintegrimin për fëmijët përdorues të substancave narkotike janë themelore në adresimin e këtij problemi. Në vazhdimin e kësaj, duhet të krijohen programe të përshtatshme për vetëdijesimin e të rinjve<sup>74</sup>.

**Dhuna në familje**- në raport me këtë, derisa disa punonjës socialë në Qendrat për Punë Sociale janë të kualifikuar, të tjerëve u mungojnë kompetencat dhe njohuritë, përfshirë ato rreth SKMDHF-së. Për më tepër, disa punonjës socialë vazhdojnë të këshillojnë gjykatat që t'ia japin kujdestarinë e fëmijëve kryesve, duke vlerësuar se baballarët do të ofrojë më shumë nga aspekti financiar sesa nënat, dhe duke injoruar potencialin për dhunë ndaj fëmijëve. Edukatorët dhe personeli shëndetësor nuk kanë njohuri të mjaftueshme për dhunën në bazë gjinore.<sup>75</sup> Zyrtarët e Shërbimeve Korrektuese dhe Sprovuese nuk kanë ekspertizë në hartimin e planeve të rehabilitimit dhe riintegrimin të përshtatura enkas për kryesit e veprave të dhunës. Megjithatë ekziston kurrikulumi dhe disa zyrtarë kanë marrë pjesë në trajnime, zyrtarët e QAP-ve dhe të punësimit edhe më tej nuk janë të informuar në mënyrë të mjaftueshme rreth përdorimit të qasjes që përqendrohet te viktime gjatë punës me personat që kanë pësuar dhunën me bazë gjinore. Shërbimet e rehabilitimit të viktimeve mungojnë, përfshirë shërbimet e shëndetit mendor.<sup>76</sup>

<sup>73</sup> RrGGK, Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë, 2016, në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20170206150329907.pdf>.

<sup>74</sup> Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2018, fq.71

<sup>75</sup> RrGGK, Nga Fjalët ne Vepra, 2017, në: <https://womensnetwork.org/sq/publications/nga-fjalet-ne-vepra/>

<sup>76</sup> Po aty

**Situata lidhur me HIV dhe AIDS-** Është pozitive që Kosova vazhdon të ketë përhapje të ulët të numrit të personave të infektuar me HIV dhe AIDS , megjithatë diskriminimi dhe stigma janë ndër pengesat kryesore për qasje në shërbime shëndetësore, sociale dhe juridike. Prandaj, është e rëndësishme të evidentohet dhe të zbulohet se çfarë dëmton përpjekjet për parandalim, trajtim dhe kujdes për HIV, cili është shkaku i frikës për të kërkuar informacion dhe shërbime për të zvogëluar rrezikun për infeksion, ose regjistrimin për trajtim dhe kujdes. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se stigma dhe rrjedhimisht, diskriminimi ndaj popullatave kyqe në rrezik për HIV ekziston dhe është mjaft e lartë në mesin e profesionistëve në sektorin publik. Profesionet që kishin stigmë të nivelit më të lartë ishin hetuesit e policisë, punonjësit socialë, profesionistët e tjerë shëndetësorë dhe infermierët. Mesatarisht, anëtarët e këtyre profesioneve ranë dakord me deklaratat negative në lidhje me popullatat kyqe në rrezik për HIV dhe PJHIV, më shumë se të tjerët<sup>77</sup>. Vëmendje e shtuar duhet ti kushtohet edhe personave të prekur nga sëmundjet malinje, tuberkulozit (TBC), e sidomos grave dhe fëmijëve të prekur nga kanceri.

Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 1 mijë e 586 raste të reja me kancer në Kosovë, ku dominon kanceri i gjirit. Ndryshe, në Kosovë rreth 50 fëmijë në vit po preken vetëm me sëmundjen e kancerit. Ekspertë shëndetësorë vlerësojnë se numri i fëmijëve të prekur me kancer është rritur brenda vitesh, nëse krahasohet me vitin 2008, kur në vit janë diagnostifikuar vetëm shtatë fëmijë me sëmundje të kancerit. Institucionet publike shëndetësore në Kosovë vazhdojnë të mos i ofrojnë disa shërbime për të cilat pacientët detyrohen të kërkojnë shërim jashtë vendit. Sipas hulumtimeve të bëra, vlerësohet se në përgjithësi trajtimi i pacientëve jashtë vendit u kushton qytetarëve nga **150 deri në 200 milionë euro në vit**<sup>78</sup>.

Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm (SDGs) bëjnë thirrje për sigurimin e jetës së shëndetshme dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat. Qeveria e Kosovës iu bashkohet aspiratave të vendeve të moderuara në botë për arrijtjen e këtij synimi.

#### **4.4 Mbrojtja e mjedisit**

Bashkimi Evropian i jep prioritet të lartë mbrojtjes së ambientit. Me 10 Nëntor 2020 është mbajtur Samiti i Sofjes, i cili është vazhdimësi e procesit të Berlinit, me ç'rast vendet e Ballkanit Perëndimor , pjesë e së cilës është edhe Kosova nën patronatin e Bashkimit Evropian, nënshkruan "Agjendën e Gjelbërt", një marrëveshje që synon përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit dhe kalimin në një ekonomi të gjelbërt për vendet e rajonit. Kjo marrëveshje e shoqëruar edhe me një udhëzues për zbatim, konsiderohet si një katalizator drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të rajonit dhe fuqizimit të mbrojtjes së mjedisit. Kosova do të duhej të hartojë një plan kombëtar për zbatimin e Agjendës së Gjelbërt dhe të formojë një trup ndërqeveritar që do të koordinonte proceset që ndërlidhen me implementimin e kësaj Agjende.

<sup>77</sup> Hulumtimi "Matja e stigmës dhe diskriminimit ndaj popullatave kyqe në rrezik për HIV dhe personave që jetojnë me HIV, në Kosovë"- Tetor 2019, Prishtinë, Kosovë.

<sup>78</sup> <https://www.evropaelire.org/a/shërimi-jashtë-vendit-/29463211.html>.

Legjislacionit mjedisor i cili është i harmonizuar me normat dhe standardet Evropiane, konsiderohet si gurë themel në trasimin e rrugës drejt BE-së.

Kosova ende nuk është palë e asnjërës prej Konventave dhe Traktateve që rregullojnë fushën e mbrojtjes së mjedisit, por megjithatë legjislacioni mjedisor është i avancuar dhe e ka të inkorporuar frymën e Konventave, si dhe është i përafuar me acquisin e BE-së për mjedisin.

Si rezultat i moszbatimit efikas të këtij legjislacioni dhe politikave sektoriale nuk përjashtohet mundësia e cenimit të së drejtave të qytetarëve për jetë në një mjedis të shëndoshë.

Viteve të fundit, në kontinuitet ka ardhur deri te shtimi i kujdesit për mjedisin në përgjithësi e veçanërisht ruajtjen e biodiversitetit përmes politikave dhe planeve të veprimit. Shtimi i numrit të zonave të mbrojtura (rreth 11,53%) e territorit të Kosovës është nën regjim të zonave të mbrojtura natyrore, e po ashtu janë ndërmarrë masa në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave, përmes licencimit të kompanive që merren me menaxhimin e mbeturinave komunale. Më tutje, kontrollin e importit të mbeturinave si lëndë e parë dhe vendosja e sistemit të monitorimit për cilësinë e ajrit, gjithashtu ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e kushteve mjedisore. Rezultate të prekshme ka edhe në fushën e mbrojtjes së resurseve ujore përmes shpalljes së Zonave të mbrojtura ujore dhe lëshimit të pëlqimeve e lejeve për këtë resurs natyror.

Zbatimi i legjislacionit mjedisor si: Ligjit për Mbrojtjen e mjedisit, Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Ligji për Vlerësim Strategjik Mjedisor, ka ndikuar dukshëm që operatorët ekonomikë t'i nënshtrohen procedurave për pajisje me pëlqim e më pastaj leje mjedisore.

Në nivel të Kosovës mbulueshmëria me shërbimin e ujësjellësit në zonat e veprimit të ndërmarrjeve publike është 94%, ndërsa mbulueshmëria me shërbimin e kanalizimit është 74 %.

Mbulimi i përgjithshëm me shërbim të mbeturinave në nivel vendi nacional është 71.9%<sup>79</sup>.

Sa i përket cilësisë së ujit të pijes që ofrohet nga ndërmarrjet publike, 99,4 % e mostrave kanë qenë në përputhje me standardet vendore të cilësisë së ujit. Në aspektin bakteriologjik 99.3% ndërsa në aspektin e cilësisë fiziko-kimike, 99.5% e mostrave janë në përputhje me vlerat e lejuara<sup>80</sup>.

Në funksion të mbrojtjes së biodiversitetit, Kosova deri me tani ka shpallur 210 zona të mbrojtura të natyrës të kategorive të ndryshme me sipërfaqe prej 125804.1 ha. ose 11.53 % e territorit të përgjithshëm të Kosovës<sup>81</sup>. Përkundër shtimit të kujdesit për mbrojtjen e mjedisit, janë evidentuar raste të cenimit të së drejtës së qytetarëve në mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Realizimi i mjedisit të pastër dhe të qëndrueshëm paraqet një sfidë të madhe për shkak të zhvillimit ekonomik, shtimit të numrit të popullatës dhe tendencës për lëvizje nga zonat rurale në qendrat urbane. Kosova duhet të ndërmarrë shumë hapa për të përmirësuar mjedisin, ende përballet me sfida domethënëse në lidhje me ndotjen e ajrit, ndotjen e ujit, eficiencën e energjisë dhe menaxhimin e mbeturinave. Në anën tjetër, liqenet dhe pyjet e bukura janë të

---

<sup>79</sup> Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit 2019, AMMK.

<sup>80</sup> Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimit të ujit në Kosovë 2018, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).

<sup>81</sup> Agjensioni për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës, 2019.

ndotura me mbeturina kurse fëmijët e nivelit shkollor nuk kanë mundësi të luajnë jashtë për shkak të ajrit të ndotur.

Gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave paraqet kërcënim serioz për shëndetin publik dhe mjedisin. Gjithsesi, ende ka shumë hapësirë për përmirësim në lidhje me mbledhjen, ndarjen, riciklimin, sistemet e trajtimit dhe infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave<sup>82</sup>.

Fakti që vetëm 60%<sup>83</sup> e mbeturinave deponohet në deponi rajonale është tregues i mjaftueshëm që 40% e mbeturinave hidhen në tokë dhe lumenj. Sipas informatave, në territorin e vendit gjenden rreth 1572 të deponive ilegale<sup>84</sup>.

Të zbehta janë veprimet e ndërmarra në drejtim të vetëdijesimit dhe edukimit të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit. Organet kompetente nuk kanë arritur të përmbushin detyrimet ligjore për planifikimin e aktiviteteve si masa preventive të mbrojtjes së ajrit nga ndotja. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) rrallë ka kryer analiza të mirëfillta gjinore për të informuar politikën, programet dhe aktivitetet, obligim i cili rrjedh direkt nga Ligji për Barazi Gjinore<sup>85</sup>. MMPH-ja dhe autoritetet përgjegjëse komunale rrallë organizuan konsultime publike, dhe gratë ishin të nënpërfaqësuar në radhët e pjesëmarrësve. Gratë po ashtu janë të nënpërfaqësuar në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.<sup>86</sup> Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShP), karshi ndotjes alarmante të ajrit, ujit dhe tokës përsëri nuk ka arritur ta përmbushë obligimin ligjor, për të dalë me një hulumtim mbi bazën e të dhënave relevante (Sistemi i Informimit Shëndetësor-SISH ende nuk është funksionalizuar), i cili do të elaboronte ndikimin e ndotjes së mjedisit në jetën dhe shëndetin e qytetarëve e për sëmundjet si rezultat i ndotjes, e që njëherësh do t'i propozonte masat parandaluese për eliminimin e mangësive.<sup>87</sup>

Institucionet shtetërore, duhet do të ndërmarrin veprime serioze për t'iu bashkëngjitur iniciativës globale lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, si: qasja në ujë të pastër dhe kanalizim; sigurimi i qasjes në energji të përbalueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë; të bërit e qyteteve dhe vendbanimeve të jetuara nga njerëzit gjithëpërfshirëse, të përshtatshme dhe të qëndrueshme; marrjen e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj; mbrojtjen e ujërave; mbrojtjen, rivendosjen dhe promovimin e qëndrueshëm të ekosistemit tokësor, menaxhimin në mënyrë të qëndrueshme të pyjeve, luftimin e shkretëtirëzimit, ndalimin e degradimit të tokës dhe ndalimin e humbjes së biodiversitetit.<sup>88</sup>

Mbrojtja e mjedisit do të jetë prioritet për Qeverinë e Kosovës, për të përmirësuar standardet e jetesës së qytetarëve të Kosovës.

---

<sup>82</sup> <https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/54339/node/54339>.

<sup>83</sup> Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2017, "Mbeturinave", fq. 71.

<sup>84</sup> Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës "Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë, Raport mbi gjendjen", fq. 85.

<sup>85</sup> Ligji për Barazi Gjinore, Neni 5, Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

<sup>86</sup> Analiza Gjinore e Kosoves, RrGK,2018: <https://emomensnetëork.org/ëp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

<sup>87</sup> Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2018, fq.70.

<sup>88</sup> Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2018, fq.56.

## **Të drejtat e njeriut nga aspekti i sigurisë së ushqimit**

Qasja e integruar në BE- e sigurisë ushqimore që Kosova synon të ndjekë, ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë ushqimore nëpërmjet masave koherente dhe monitorimit të përshtatshëm nga prodhuesi deri te konsumatori, duke siguruar funksionimin efektiv të tregut të brendshëm dhe eksportin e produkteve ushqimore të Kosovës në tregun evropian e me gjerë.

Objektivi strategjik i Qeverisë së Kosovës është garantimi në shkallën më të lartë të shëndetit të qytetarëve dhe fuqizimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe garantimit të sigurisë ushqimore. Ky sistem do të shërbejë për mbrojtjen sa më të mirë të shëndetit të konsumatorëve nga sëmundjet/dëmtimet si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimore ose shtazore. Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike synojnë fuqizimin e një sistemi me funksionim të plotë të sigurisë ushqimore dhe të mbrojtjes së konsumatorit që mbulon të gjithë vendin, si dhe monitorim dhe kontroll modern në përputhje me standardet e BE-së. Rëndësia e vendosjes së politikës së ushqimit dhe të ushqyerit si një synim kyq i politikës së zhvillimit është një objektivi strategjik që reflekton trendet globale dhe vendore.

Çdo hallkë e vetme e zinxhirit duhet të jetë shumë e fortë në rast se synohet që shëndeti i konsumatorit të jetë plotësisht i mbrojtur. Ky parim është i vlefshëm pavarësisht nga fakti nëse ushqimet prodhohen në Kosovë apo importohen nga vendet e tjera.

Për këtë arsye, Qeveria do të këtë në vëmendjen e saj forcimin e kontrollit dhe të monitorimit të ushqimeve që tregtohen në tregun e Kosovës të destinuara për konsum njerëzor, si dhe të ushqimeve që përdoren për kafshë.

Qeveria e Kosovës i konsideron politikat për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit si një prioritet të rëndësishëm. Këto politika janë nën përgjegjësinë e MBPZHR e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe strategjive të sigurisë ushqimore, si dhe për krijimin e kuadrit ligjor dhe koordinimin e harmonizimit të legjislacionit vendor me kuadrin ligjor të BE-së.

### **4.5 Barazia dhe mbrojtja nga diskriminimi**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në kapituj të veçantë, garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe barazisë para ligjit. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuptimin normativ e paraqet bazën e parimeve dhe rregullave ligjore për sigurimin e mundësive të barabarta, trajtimit të barabartë dhe për mbrojtje nga diskriminimi në Kosovë.

Përkundër garancive kushtetuese dhe ligjore nuk janë të pakta rastet e diskriminimit të shkatuara qoftë në sektorin publik apo privat, sipas të dhënave të pezantuara në raportin vjetor të Avokatit të Popullit. Nga periudha 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018, Avokati i Popullit ka pranuar 189 ankesa me bazë diskriminimi, prej të cilave për hetim janë hapur 98, ndërsa 70 ankesa janë vlerësuar të pa pranueshme. Përveç ankesave të paraqitura nga qytetarët, Avokati i Popullit ka hapur 21 raste për hetim sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*).

**Barazia Gjinore dhe mbrojtja nga diskriminimi**- Kushtetuta e Republikës së Kosovës barazinë gjinore e nënkupton si vlerën themelore në një shoqëri e cila ka për synim zhvillimin e demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave të barabarta të grave dhe të burrave. Korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është avancuar dukshëm me aprovimin e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut<sup>89</sup>. Për më tepër, një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore janë përpiluar dhe adaptuar nga institucionet e Kosovës me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të standardeve mbi të drejtat e njeriut në Kosovë, duke mbuluar në këtë mënyrë rastet e diskriminimit<sup>90</sup> dhe barazisë gjinore, si dhe fuqizimit të organeve që merren me të drejtat e njeriut dhe mandatit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë.

Rezultatet mbeten të vogla kur është fjala për zbatim. Kapacitetet institucionale për të zbatuar këto ligje ende nuk janë në nivelin e duhur. Ligji për Barazi Gjinore nuk ka gjetur zbatim adekuat në praktikë. ABGJ-ja duhet t'i adresojë kufizimet dhe sfidat e saj të vazhdueshme, me fokus të veçantë në zbatimin e kornizës ligjore përkatëse dhe në nxitjen e politikbërjes gjinore të bazuar në dëshmi<sup>91</sup>. Në funksion të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Qeveria e Kosovës ka hartuar dhe miratuar Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2020-2024), të udhëhequr nga Agjencia për Barazi Gjinore. Prandaj mbetet që legjislativi, gjyqësori dhe ekzekutivi të veprojnë në praktikë për zbatimin e ligjit dhe të sigurojnë që parimi i barazisë të mos mbetet vetëm vlerë e garantuar *de jure*, por edhe *de facto*.

Mbeten të pakta dhe rastet pranë gjykatave të rregullta dhe institucioneve publike që kanë të bëjnë me diskriminimin. Gjykatat e rregullta rrallëherë shfrytëzojnë pakon e ligjeve mbi të drejtat e njeriut në bazë të parimeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës apo edhe referimit në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Rastet për diskriminim janë gjithashtu të rralla në praktikën gjyqësore të Kosovës, i cili është një tjetër problem që pengon procesin e ngritjes së vetëdijes në mesin e gjyqtarëve, studentëve të drejtësisë, apo viktimave në vlerësimin vendimeve të gjykatave në rastet e diskriminimit<sup>92</sup>. Individët rrallë paraqesin lëndë kundër diskriminimit në gjykata dhe kur çështjet shqyrtohen, ligjet nuk zbatohen në mënyrë korrekte.

Pengesa të mëtejme në zbatim janë mungesa e vazhdueshme e mbledhjes dhe e zhvillimit të një mekanizmi hetues në monitorimin e rasteve të diskriminimit nga institucionet publike. Në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, të gjitha institucionet duhet të mbledhin dhe të dorëzojnë pranë Agjencisë së Statistikave të Kosovës të dhënat të ndara sipas gjinisë për qëllime të raportimit dhe monitorimit të rregullt. Mungon mbledhja, analizimi dhe raportimi lidhur me raportet për rastet e lidhura me diskriminimin, duke

---

<sup>89</sup> (Pakoja e ligjeve për të drejtat e njeriut përfshinë; Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Avokatin e Popullit).

<sup>90</sup> Termi "diskriminim" nënkupton dallimet që ekzistojnë në trajtimin e individëve ose mohimin e të drejtave të garantuara në të gjitha fushat e jetës, për shkak të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër.

<sup>91</sup> LIGJI PËR BARAZI GJINORE 2015 VLERËSIMI I EX-POST I NDIKIMIT RREGULLATIV.

<sup>92</sup> Nuk ka doracakë specifike vetëm për diskriminim që janë në dispozicion për gjyqtarët me legjislacione, konventa dhe raste nga gjykata për të ngritur ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve në lidhje me legjislacionin dhe praktikën gjyqësore ekzistuese për mbrojtjen nga diskriminimi dhe identifikimi i diskriminimit.

përfshirë rastet e diskriminimit me **bazë gjinore** dhe ato të **ngacmimit seksual**, në harmoni me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ato të Ligjit për Barazinë Gjinore. Këtu përfshihet mirëmbajtja dhe raportimi i të dhënave statistikore të kategorizuara sipas gjinisë, lidhur me rastet, procedurat dhe vendimet në rastet e diskriminimit dhe ngacmimit (seksual), si dhe informatat lidhur me kompensimin e dhënë dhe gjobat e arkëtuara.<sup>93</sup> Statistikat e vendimeve gjyqësore në rastet e diskriminimit nuk janë në dispozicion për publikun. Ato nuk janë në dispozicion për shkak të mungesës së sistemit të duhur/bazës së të dhënave për mbledhjen e të dhënave nga gjykatat. Në Kosovë ende nuk ekziston një mënyrë sistematike e shpërndarjes së vendimeve gjyqësore mbi rastet e diskriminimit në institucionet përkatëse. Vendimet gjyqësore duhet të publikohen në bazë të Ligjit për Gjykatat. Megjithatë, qasja në vendime për publikun është e vështirësuar, në veçanti në rastet e diskriminimit, për shkak të mungesës së filtrit.<sup>94</sup> Në bazë të praktikës së dëshmuar, rastet e regjistruara mbeten të ulëta në gjykata dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Kosova mbetet prapa në zbatimin efektiv të pakos së ligjeve mbi të drejtat e njeriut<sup>95</sup>. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një normë transversale e cila ka për qëllim të krijojë një kornizë të përgjithshme për veprim publik për luftimin e diskriminimit në të gjitha format e tij, në pajtim me parimet e përcaktuara në direktivat e ndryshme evropiane.

Konform Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, institucionet në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes duhet të krijojnë politika publike të cilat kanë për synim përmirësimin e situatës së komuniteteve (grupeve) të marginalizuara me anë të veprimeve-masave afirmative, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore<sup>96</sup>. Duhet të inkurajohet dhe vazhdohet zbatimi i praktikave të mira sa i përket inicimit dhe zbatimit të masave afirmative dhe masave të veçanta konform legjislacionit në fuqi<sup>97</sup>.

**Diskriminimi në punë dhe tregun e punës-** Garancitë kushtetuese për të drejtën e punës dhe të drejtën për zgjedhjen e lirë të profesioneve, krijojnë detyrimin e shtetit për t'i mbrojtur këto të drejta në mënyrë të barabartë dhe për ta siguruar respektimin dhe zbatimin e plotë të legjislacionit përkatës.

Dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë të zbatueshme drejtpërdrejt kur bëhet fjalë për marrëdhëniet e punës ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik. Përkundër garancive kushtetuese dhe ligjore, vetëm gjatë vitit 2018, Inspektorati i Punës ka pranuar 515-të ankesa formale lidhur me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në sektorin publik dhe privat.

<sup>93</sup> Shih Raportin "Ngacmimi seksual në Kosovë (Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës- Prishtinë, Kosovë 2016).

<sup>94</sup> Shih Raportin-Studimin Regjional-"Mbrojtja ligjore kundër Diskriminimit në Evropën Juglindore.

<sup>95</sup> "Një sistem i shfrytëzuar pak: Gjendja e Kornizës së të Drejtave të Njeriut në Kosovë", 28.08.2017.

<sup>96</sup> Ka disa shembuj të mirë të veprimeve afirmative të ndërmarra nga autoritetet për të adresuar pabarazinë midis kategorive të rrezikuara të popullatës së Kosovës. Për shembull, në procesin e parandalimit të pa-shtetësisë në mesin e popullsisë së Kosovës, komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas, duket të jetë më të cenueshme sa i përket mungesës së regjistrimit civil dhe të gjendjes civile. Për të mbështetur procesin e regjistrimit civil të ndihmuar nga UNHCR-ja dhe CRP/K, Qeveria e Kosovës ka lëshuar një letër qarkore përmes së cilës anëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas janë liruar nga pagesa e taksave administrative dhe gjobave të cilat janë të parapara me ligj për regjistrim të vonuar. Përzgjedhja e pjesëtareve të komuniteteve, romë, ashkali dhe egjiptas në këtë rast ishte e bazuar në vlerësimin e përgjithshëm se këto komunitete janë më të cenueshme në pothuajse të gjitha aspektet e jetës së tyre.

<sup>97</sup> Në vitin 2016, Qeveria e Kosovës kishte aprovuar Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 08/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (QRK) nr. 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së palujtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve, dhe është vazhduar për katër vite me rradhë.

Institucionet kryesore, të cilave u është besuar zbatimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit të punës, janë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe Inspektorati i Punës.

Përkundër garancive ligjore, shkeljet e të drejtave ligjore për shtatzëna dhe pushim të lehonisë janë ndër format më të zakonshme të diskriminimit në bazë gjinore në punë. Përdorimi i kontratave afatshkurtra për të shmangur pagimin e pushimit të lehonisë është gjithashtu i pranishëm. Ishte shqetësues konstatimi se 62% e të anketuarave të cilat kishin marrë pushimin e lehonisë gjatë kohës që ishin të punësuar në sektorin privat, as nuk ishin paguar dhe as nuk kishin marrë ndonjë kompensim nga Qeveria<sup>98</sup>.

Është shqetësues edhe mos raportimi i rasteve të diskriminimit në baza gjinore nga ana e atyre që kishin provuar diskriminim të bazuar në bazë të gjinisë në punë: shumica e grave (76%) dhe burrat (83%) nuk e raportuan atë në asnjë institucion<sup>99</sup>.

Gjithashtu, Inspektorati i Punës nuk posedon një **sistem elektronik të të dhënave** që do të mundësonte klasifikimin e rasteve bazuar në shkelje specifike. Kështu, nuk ekziston asnjë informacion i konsoliduar në lidhje me rastet e raportuara pranë Inspektoratit të Punës, përfshirë këtu edhe diskriminimin me **bazë gjinore**.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka një bazë elektronike të dhënash ku regjistrohen ankesat e pranuar. Megjithatë, diskriminimi me bazë gjinore nuk figuron si kategori ose filtër. Për këtë arsye është e vështirë të vlerësohet numri i rasteve të diskriminimit me bazë gjinore në punë, të adresuara nga Avokati i Popullit<sup>100</sup> por edhe nga Inspektorati i Punës.

Ka dëshmi gjithashtu që sugjerojnë që gratë e reja janë të diskriminuara në procesin e rekrutimit.<sup>101</sup> Nga gratë kërkohet të ndajnë informacion në lidhje me planet e tyre familjare në intervistat për punë, dhe rrjedhimisht, disa gra raportojnë se nuk marrin oferta pune nëse e kanë në plan për të mbetur shtatzënë. Të tjerave u janë anuluar kontratat e punës pasi kanë bërë të ditur se janë shtatzënë. Në një studim, në pyetjen rreth përzgjedhjes së kandidatëve për punësim, 55% e punëdhënësve thanë se nuk marrin parasysh planet familjare të kandidatit për punë gjatë procesit të punësimit, ndërkaq 45% thanë se i marrin parasysh. Kjo sugjeron që disa punëdhënës po i diskriminojnë gratë në procesin e punësimit bazuar në planet e tyre familjare. Në një studim tjetër, 28% e grave të punësuar të anketuara pohojnë se janë diskriminuar në punë.<sup>102</sup> Për më tepër, deri një e treta kishin përjetuar paragjykime gjinore në punë, edhe pse vetë ato nuk e konsideronin këtë doemos si diskriminim. Kjo sugjeron që gratë mund të mos e dinë gjithmonë se çka

---

<sup>98</sup> Shih, Hulumtimin - GENDER-BASED DISCRIMINATION AND LABOUR IN KOSOVO, fq.47.

<sup>99</sup> Shih, Hulumtimin - GENDER-BASED DISCRIMINATION AND LABOUR IN KOSOVO, fq.32.

<sup>100</sup> Shih Hulumtimin -DISKRIMINIMI ME BAZË GJINORE DHE PUNËSIMI NË KOSOVË, fq.57.

<sup>101</sup> Rrjeti i Grave të Kosovës, Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë, 2019, në: [https://ëomensnetëork.org/ëp-content/uploads/2019/05/RrGK\\_Diskriminimi-me-bazë-gjinore-dhe-punësimi-në-Kosovë\\_REV\\_FIN.pdf](https://ëomensnetëork.org/ëp-content/uploads/2019/05/RrGK_Diskriminimi-me-bazë-gjinore-dhe-punësimi-në-Kosovë_REV_FIN.pdf).

<sup>102</sup> Instituti "Riinvest", Gratë në tregun e punës: Analizë e kushteve të punës për gratë në Kosovë, Prishtinë: 2017, fq. 9, marrë nga: <https://riinvestinstitute.org/Al/publications/249/gratë-në-tregun-e-punës/>.



përbën diskriminim. Nuk ka të dhëna të ngjashme të disponueshme nga burrat e punësuar për të mundësuar krahasimin.<sup>103</sup>

Pushimi prindëror vazhdon të jetë diskriminues dhe jo i barabartë. Ligji aktual është hartuar mbi një shpërndarje të pabarabartë të përgjegjësisë prindërore midis nënave dhe baballarëve, gjë që përforcon ndarjet tradicionale të përgjegjësisë, ku nëna supozohet se është kujdestarja kryesore. Duke u përpjekur të mbrojnë marrëdhëniet e veçanta ndërmjet nënës dhe fëmijës, Ligji i mohon babait mundësinë për të krijuar një marrëdhënie të tillë me fëmijën e tij gjatë periudhës së menjëhershme pas lindjes<sup>104</sup>. Në praktikë, të konsiderueshme janë dëshmitë që lënë të kuptohet se këto dispozita ligjore kanë bërë që punëdhënësit të shmangin punësimin e grave që ngelin shtatzëna, duke kontribuar kështu tërthorazi në diskriminimin me bazë gjinore në procesin e marrjes në punë<sup>105</sup>.

Në Raportin 2020 për Vendin, Komisioni Evropian konfirmoi se ekziston nevoja për reformimin e sistemit të pushimit të lehonisë dhe prindëror në harmoni me legjislacionin e BE-së, meqenëse aktualisht përbën një pengesë për punësimin e grave, sidomos në sektorin privat<sup>106</sup>. Projektligji i tanishëm i Punës është po aq diskriminues, pasi që përjashton pushimin e lehonisë, atë atësor dhe prindëror nga dispozitat rregullative, duke i vendosur të njëjtat në një projektligj tjetër të veçantë, e duke mos i trajtuar gratë kështu fuqi e barabartë në tregun e punës. Njëherit, ky Projektligj nuk ofron pushim me pagesë për baballarët, dhe as nuk ofron një model të qëndrueshëm, që do t'i reduktonte barrën e pagesës punëdhënësit, konkretisht, sektorit privat – duke mos kontribuar fare në rritjen e shkallës së punësimit të grave.

**Ngacmimi seksual në vendin e punës** -Kudri ligjor dhe institucional në Republikën e Kosovës është i plotë dhe në përputhje me atë të Bashkimit Evropian. I njëjti jep garanci të mjaftueshme ligjore dhe ofron mbrojtjen e nevojshme nga ngacmimi seksual në administratën publike. Qeveria e Kosovës tashme e ka aprovuar Politikën kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike në Kosovë. Qëllimi i politikës kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike në Kosovë, është që të shërbejë si udhëzues për parandalimin e të gjitha formave të ngacmimit seksual në vendin e punës me udhëzime për sigurimin e një ambienti pune pa diskriminim dhe ngacmimet seksuale në të gjitha organet e administratës publike. Me këtë politikë mbrohet barazia gjinore dhe trajtimi i barabartë si vlera themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, përmes ndalimit të çdo akti/sjelljeje që cenon dinjitetin personal të secilit/ës të punësuar në organet e administratës publike.

---

<sup>103</sup> Rrjeti i Grave të Kosovës, Analiza Gjinore e Kosovës, 2018.

<sup>104</sup> Craig, P. Dhe Gráinne de Búrca, EU Law: Text, Cases and Materials (5th). [E drejta e BE-së: Tekste, raste dhe materiale], 2011, fq. 877, ku vihet në dukje e njëjta gjë si në rastin e GJED-së nr. 184/83 Hofmann marrë nga: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A61983CJ0184>.

<sup>105</sup> RRGK, "Progresi i Kosovës në harmonizimin e ligjeve me Acquis-in për Barazinë Gjinore të Bashkimit Evropian", rikonfirmuar nga të intervistuarit në institucione të ndryshme (intervista të RRGK-së, 2018).

<sup>106</sup> "Kosovo should amend and enforce the Law on labour in line with relevant EU acquis, in particular in relation to non-discrimination in employment and parental leave", Kosovo Progress Report 2020, në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

Organet e administratës publike në Republikën e Kosovës duhet ta promovojnë dhe shpërndajnë këtë politikë si dhe të ndërmarrin hapa konkretë për të vetëdijësuar të gjithë të punësuarit/at në organet e administratës publike rreth ngacimit seksual në vendin e punës dhe mekanizmat ku duhet raportuar atë. Organet e administratës publike duhet të ndërmarrin hapa në mënyrë që të sigurohen rastet e raportimit të ngacimit seksual dhe formave tjera të ngacimit të trajtohen në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe të besueshme, duke e respektuar konfidencialitetin e raportuesve/eve si dhe të ndërmerren masa e veprime ndëshkimore konkrete në përshtatshmëri me rrethanat kur ngacimi është përcaktuar se ka ndodhur. Zyra për Qeverisje të Mirë, obligohet të merr masa dhe veprime në zbatim të kësaj politike si vijon: të zhvillojë fushata nacionale vetëdijesuese në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes; të monitorojë procesin e funksionimit të komisioneve disiplinore në nivel të administratës në përputhje me ligjet në fuqi; të punojë ngushtë me organizata të shoqërisë civile dhe institucione në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve në nivel qendror dhe lokal, në zbatim të kësaj politike.

Mirëpo, përkundër garancive kushtetuese dhe ligjore, rastet e ngacimit seksual janë duke ndodhur. Gjatë vitit raportues 2019, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga qytetarët lidhur me diskriminimin në marrëdhëniet e punës. Natyra e ankesave ka të bëjë me shkelje të së drejtës për punë në procedurat e konkurseve për zgjedhje dhe avancime, pastaj edhe me ngacim seksual në vendin e punës. Avokati i Popullit ka pranuar tri ankesa të tjera lidhur me ngacimin seksual në vend pune<sup>107</sup>.

**Diskriminimi në bazë të moshës dhe gjinisë** - Jo rrallë, ndodh që gjatë shpalljes së konkurseve për pozita të lira, qoftë në sektorin publik apo privat, të hasim në elemente diskriminuese dhe përjashtuese në bazë të moshës dhe gjinisë. *Gjithashtu, vlerësohet diskriminues kriteri i vendosur në konkurse mbi deklaratimet lidhur me gjininë dhe statusin martesor të aplikuesve*<sup>108</sup>.

Nuk janë të pakta rastet kur gjuha e përdorur në konkurse si në sektorin publik dhe në atë privat ndikon në pabarazinë gjinore. Përkundër se Ligji për Barazi Gjinore i obligon punëdhënësit që me rastin e shpalljes së vendit të lirë të punës të shmangin elementet diskriminuese në bazë të **gjinisë**, në sektorin privat Ligji pothuajse nuk aplikohet, ku në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkohen gra ose burra për pozita të caktuara. Nga 562 konkurse që Instituti GAP i ka analizuar, vërehet se në konkursat e bizneseve private për pozitat si asistente, shitëse, receptioniste, pastruese, kërkohen kryesisht gra, kurse në pozitat si menaxher, drejtor, inxhinier kërkohen kryesisht burra. Në anën tjetër, në sektorin publik gratë mbesin më pak të përfaqësuara në pozita të larta drejtuese, kjo për shkak se konkursat për këto pozita përmbajnë gjuhë të kodifikuar mashkullore e cila i dekurajon gratë për të aplikuar. Sipas të dhënave zyrtare<sup>109</sup>, Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës përbëhet nga 18,712 nëpunës civilë, prej tyre nga 60 për qind meshkuj dhe 40 për qind femra. Këto të dhëna duhet të përmirësohen, me qëllim që të sigurohet përfaqësimi i barabartë gjinor në shërbimin civil. Niveli qendror ka 12,314 nëpunës civil, ndërsa niveli

<sup>107</sup> Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2019, fq.80.

<sup>108</sup> Ky shqetësim u ngrit në takimin e organizuar në muajin Prill 2019 me rrjetin e 26 organizatave jo-qeveritare të cilat punojnë në ombrellën e projektit 4 vjeçarë të financuar nga Bashkimi Evropian "Të drejtat e barabarta për të gjithë" apo "Equal Rights for all Coalition – (ERAC)".

<sup>109</sup> RAPORT PËR GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2018.

lokal ka 6,398. Numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë në vitin 2018 ishte 18,712, prej të cilëve 11,236 të gjinisë mashkullore dhe 7,476 të gjinisë femërore. Në nivel qendror, janë gjithsej 12,314 nëpunës civilë prej të cilëve 6,942 të gjinisë mashkullore dhe 5,372 të gjinisë femërore. Në nivelin lokal ka gjithsej 6,398 nëpunës civilë, prej të cilëve 4,294 të gjinisë mashkullore dhe 2,104 të gjinisë femërore. Këto të dhëna tregojnë se institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës nuk i kanë respektuar kërkesat ligjore lidhur me përfaqësimin gjinor në shërbimin civil. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se viti 2018 tregon një përmirësim të lehtë. Në funksion të promovimit të barazisë gjinore dhe vetëdijësimit të zyrtarëve në nivelin lokal lidhur me respektimin dhe arritjen e barazisë gjinore, Ministria e Pushtetit Lokal, në kuadër të sistemit të menaxhimit të performancës komunale ka përfshirë si fushë të veçantë edhe **barazinë gjinore me gjithsej 11 indikatorë.**

Shkalla e përmirësimit të këtyre indikatorëve do të jetë një ndër parakushtet për përfitim të komunave në grantin për performancë. Në vitin 2019, me rastin e ndarjes së shpërblimeve për komunat në bazë të performancës, 200.000 mijë euro janë ndarë për komunat të cilat kanë treguar performancë në fushën e barazisë gjinore. Përpjekje të mëtutjeshme janë të nevojshme në rekrutimin e nëpunësve civilë në kuadër të Reformës së Administratës Publike, duke marrë për bazë dispozitat e Ligjit për Barazi Gjinore. Si pjesë e reformës së financave publike dhe programimit të reformës së administratës publike, qeveria duhet të institucionalizojë trajnime të detyrueshme për të gjithë nëpunësit publikë në të gjitha nivelet për barazinë gjinore, përfshirjen e aspektit gjinor në politikat publike, BPGJ-në dhe strategjitë për përmirësimin e pjesëmarrjes publike, duke shfrytëzuar kurrikulat ekzistuese dhe trajnuesit e kualifikuar të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP).

Njëherit, në kuadër të Reformës së Administratës Publike, ende duhet të aplikohet zbatimi i vlerësimit të ndikimit gjinor si mjet informues i politikave, në përputhshmëri me Strategjinë për Rregullim më të mirë për Kosovën 2017-2021.

**Diskriminimi i punëtorëve në sektorin publik dhe privat-** Avokati i Popullit konsideron se nuk ka pasur përparim të dukshëm dhe përmirësim të situatës në lidhje me respektimin e të drejtave të punëtorëve dhe kushteve të punës. Edhe më tutje vazhdon të jetë prezente shkelja e të drejtave të punëtorëve. Pozita e të punësuarve vazhdon të jetë veçanërisht e rëndë në sektorin privat, ku përgjithësisht nuk ka organizata sindikale që do të mbrojnë të drejtat e punëtorëve.

Në sektorin privat, shumica e shkeljeve lidhen me moszbatimin e Ligjit të Punës dhe akteve tjera ligjore që rregullojnë çështjen e pagesës, orarin e punës, pushimet, punën jashtë orarit, pagën minimale, pagesën e kontributeve pensionale etj<sup>110</sup>.

Diskriminimi i punëtorëve është më i theksuar në sektorin e ndërtimit, tregtisë, hotelierisë dhe industrisë. Ende është i theksuar problemi i punës joformale, pa kontratë pune, që sjell deri te përjashtimi i sigurisë juridike për personat që punojnë pa kontratë<sup>111</sup>. Prej muajit shtator, Inspektorati i Punës ka pranuar 204

<sup>110</sup> Instituti Demokratik i Kosovës, Raporti "Të Drejtat në letër", fq.21.

<sup>111</sup> Sipas përfaqësuesve të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, vlerësohet se në tregun e punës, më se 60% e punëtorëve, punojnë pa kontratë pune. Gjithashtu Inspektorati i Punës vetëm në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, ka hasur mbi 900 raste të punëtorëve pa kontratë pune.

ankesa formale për shkeljet e të drejtave të punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Organizatat e të drejtave të grave raportuan se abuzimi seksual dhe ngacmimi ndodhën në punë, por nuk u raportuan për shkak të frikës nga shkarkimi ose hakmarrja.<sup>112</sup> Grupe të caktuara të shoqërisë, sidomos ato që jetojnë të marginalizuara, janë të detyruara që të punojnë në sektorin joformal, ku përveç tjerash nuk gëzojnë kurrfarë mbrojtje – ligjore, shëndetësore, të sigurisë fizike, etj. Informaliteti i lartë në punësim shkaktohet nga mungesa e zbatimit të mirëfilltë të legjislacionit mbi të drejtat e punëtorëve, sidomos nga ana e Inspektoratit të Punës. Ky i fundit vuan nga mungesa e kapaciteteve qoftë njerëzore, qoftë teknologjike, si për shembull **sistemet për menaxhimin e informatave** si dhe mungesa e njohurive ligjore për trajtimin e formave të diskriminimit, sidomos diskriminimit në punë.

Problem tjetër i veçantë është edhe mungesa e vetëdijesimit në mesin e punëtorëve për përfitimet nga formalizimi i aktivitetit të tyre<sup>113</sup>. Pak dihet rreth ekonomisë joformale, veçanërisht nga pikëpamja gjinore. Nuk ka analizë të përpiluar gjinore e as analizë të planifikuar, që do të mund të informonte politikën e intervenimit në ekonominë joformale, implikimet gjinore apo pjesëmarrjen e burrave dhe grave në këtë lloj të ekonomisë. Një analizë e tillë do të mund të përpilohej në kuadër të Anketës së Fuqisë Punëtore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në bashkëpunim me organizatat e grave që posedojnë ekspertizë nga kjo fushë. Sipas PVGJ, duhet bërë mbështetja e kërkimeve të orientuara drejt politikave mbi ekonominë joformale dhe hendekun gjinor të pagave për të kuptuar më mirë pabarazitë gjinore dhe zgjidhjet specifike të politikave dhe veprimet për adresimin e tyre.

Të dhënat zyrtare janë të dobëta për shkak të nën-raportimit të punës me qëllim të shmangies tatimore, dhe faktit që ekzistojnë kuptime të shumëfishta të kësaj shprehjeje. Gratë e punësuar në sektorin privat, shpesh i përkasin sektorit joformal. Kjo e bën këtë kategori të grave shumë të ndjeshme ndaj riskut financiar, emocional dhe fizik. Në Kosovë për momentin i kemi **36** organe administrative që mbikëqyrin zbatimin e më shumë se **140 ligjeve** dhe janë përgjegjëse për ndërmarrjen e inspektimeve. Megjithatë, efektshmëria e këtyre inspektorateve është shumë e ulët. Kjo bën që bizneset të operojnë pa kufizimet e nevojshme ligjore (p.sh. në raport me mjedisin, punëtorët, etj.) apo edhe që të ketë pabarazi në treg për shkak të favorizimeve në rastet e inspektimeve. E gjithë kjo e pengon klimën e të bërit biznes dhe e dëmton mirëqenien e qytetarëve.<sup>114</sup>

Niveli alarmues i **29%** përqind të grave të cilat punojnë në sektorin privat pa kontratë pune, paraqet një problem shumëdimensional. Përpos mungesës së benefiteve nga kontrata, të punuarit pa kontratë pune i ekspozon punëtorët ndaj rreziqeve të mungesës së mbrojtjes ligjore që një kontratë mundëson. Punëtorët pa kontratë janë më të rrezikuar në kushtet e tyre të punës, më të prirur për të pranuar ndryshimet në orar

---

<sup>112</sup> Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën 2017, fq.34.

<sup>113</sup> Shih, Strategjia Kombëtare për Zhvillim Kombëtar 2016-2021 (SKZH), fq.18.

<sup>114</sup> Shih, Strategjia Kombëtare për Zhvillim Kombëtar 2016-2021 (SKZH).

dhe orë më të gjata të punës, për shkak të rrezikut që mund të pushohen nga puna pa paralajmërim apo vërejtje<sup>115</sup>.

Ligji i Punës ndalon diskriminimin në punësim. Kjo ka të bëjë me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës.

**Siguria e punëtorëve në vendin e punës** - Niveli i sigurisë në punë sidomos në sektorin privat, mbetet edhe më tej shqetësues, shpesh pa mbrojtje elementare, dhe për shkak të mungesës dhe mosmarrjes së masave të duhura të sigurisë në punë, kemi një numër të madh të rasteve të vdekjeve dhe të lëndimeve të rënda të punëtorëve në vendin e punës. Pasiguria, orari i gjatë i punës, vonesa e pagave, moskompensimi i pushimeve vjetore, shfrytëzimi i pagës minimale për të paguar punëtorët, abuzimi me kontrata dhe mungesa e mbrojtjes ligjore të punëtorëve janë identifikuar si faktorët që kanë ndikuar nga viti në vit të rriten numri i të lënduarve dhe të vdekurve në vendin e punës. Viti 2018, ka qenë një vit aspak i mirë sa i përket të drejtave të punëtorëve por edhe sigurisë në punë. Për më tepër, 20 vdekje në vendin e punës e përcjellën Kosovën nga janari deri në dhjetor, shumica e të cilave nga mungesa e masave të sigurisë në vendin e punës, sidomos në sektorin e ndërtimitarisë. Po në këtë vit u shënuan edhe 80 lëndime në punë në të gjithë sektorët. Në pesë vitet e fundit sipas raporteve të organizatave vendore që merren me sektorin e sigurisë në punë, kanë humbur jetën 99 punëtorë në vende të ndryshme të punës<sup>116</sup>. Kjo situatë shtron nevojën imediate për rritjen e numrit të inspektorëve, për monitorim rigoroz të zbatimit të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Mbrojtjen dhe Sigurinë në Punë, apo për plotësimi/ndryshim të ligjeve të cilat sigurojnë mbrojtjen dhe sigurinë në punë.

**Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara-** Edhe pse Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore, Qeveria nuk zbatoi në mënyrë efektive këto dispozita dhe personat me aftësi të kufizuara pësuan diskriminim. Sipas Handi-Kos, një organizatë e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, shëndetësi, asistencë sociale, rehabilitim dhe pajisje ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara, qasja fizike e pamjaftueshme në institucionet publike mbeti e vështirë edhe pas zbatimit të akteve nënligjore për ndërtimin dhe mbështetjen administrative.

Në një hulumtim të realizuar së fundmi, rezultoi se më pak se një e treta (30.72%) e detyrimeve dhe standardeve të vlerësuara ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar janë përkthyer plotësisht në legjislacionin e Kosovës. Pjesa tjetër e rreth 70% të detyrimeve i përkasin kategorive të vlerësimit pjesërisht të adresuara (50%) dhe atyre që mungojnë (19.28%). Qasja mbetet kategoria më sfiduese me vetëm 6.77% të standardeve të përfshira plotësisht në legjislacion<sup>117</sup>.

---

<sup>115</sup> Shih, Hulumtimin- Gratë në tregun e punës “analizë e kushteve të punës për gratë në Kosovë”, 2017.

<sup>116</sup> Vdekjet e Heshtura, dhjetor 2018 Iniciativa Kosovare për Stabilitet IKS, faqe 2 qasur me 28.01.2019.

<sup>117</sup> Raporti i Hulumtimit, Standardet Nërkombëtare të aftësisë së kufizuar –Ku qëndron Kosova?

**Po ashtu, edhe në sektorin e punësimit,** personat me aftësi të kufizuara janë duke u diskriminuar. Institucionet publike dhe private nuk janë duke e përmbushur obligimin ligjor që parasheh që çdo i 50-ti punëtorë të jetë person me nevoja të veçanta.

Në raportin e punës të IAP është potencuar se disa komuna nuk pranojnë që t'i lirojnë nga pagesa e tatimit në pronë personat e verbër, të cilët, sipas Ligjit nr. 04/L-192 për Personat e Verbër (neni 6) lirohen nga obligimi për të paguar tatimin në pronë, duke u bazuar vetëm në Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme<sup>118</sup>. Konkretisht, neni 6 i Ligjit për Personat e Verbër trajton vetëm një kategori të caktuar në aspektin tatimor, ndërsa Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme trajton të gjithë tatimpaguesit, duke përfshirë personat e verbër. Ky shqetësim është potencuar dhe ngritur edhe gjatë takimeve konsultative me komunitat gjatë diskutimit të draft programit për të drejtat e njeriut.

Së këndejmi, duke zbatuar parimin *lex specialis*, përjashtimi i përcaktuar në Ligjin për Personat e Verbër duhet të gëzojë përparësi kundrejt rregullit të përgjithshëm të përcaktuar në Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

**Diskriminimi në fushën e arsimit** - Organizata Joqeveritare Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR), në raportin e publikuar: “Gjuha diskriminuese në tekstet shkollore”, vlerëson se gjatë analizës së teksteve shkollore janë gjetur pjesë ku ka nuanca dhe elemente të diskriminimit gjinor, racor, etnik dhe të orientimit seksual. Ka edhe hulumtime të tjera nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, Qendra për Arsim e Kosovës të koordinuara me MASHTI, por edhe hulumtime tjera të sponsoruara nga MASHTI, të cilat adresojnë kërkesat për tekste më cilësore dhe jodiskriminuese. Gjithashtu, Avokati i Popullit në bashkëpunim me disa organizata dhe me Shoqatën Down Syndrome Kosova, ka kërkuar që të rishikohen urgjentisht tekstet shkollore të cilat cenojnë dinjitetin e personave me sindromën Down, për arsye se në këto tekste jo vetëm që bëhet diskriminimi i drejtpërdrejtë por gjithashtu cenohet edhe dinjiteti i fëmijëve të prekur me këtë sindrom<sup>119</sup>.

MASHTI nga vlerësimet e përvjetshme të rezultateve të nxënësve me testet e jashtme, por edhe nga hulumtimet, në vazhdimësi ka identifikuar problemin e teksteve shkollore dhe të metodologjisë së mësimdhënies, prandaj ka punuar intenzivisht në zhvillimin dhe avancimin e pakos së dokumenteve kurrikulare dhe tanimë është në proces të hartimit të teksteve shkollore, bazuar në kurrikulat e reja dhe Standardet për tekste shkollore (të hartuara në vitin 2011), ku sipas tyre tekstet shkollore duhet të marrin për bazë këto elemente: vërtetësinë shkencore/ bazën shkencore/përmbajtjen ndaj të arriturave bashkëkohore në fushën e caktuar; përshatjen e librit me moshën e nxënësve ( zhvillimin kognitiv, emocional dhe atë të perceptimit); aspektin psikologjik; aspektin metodik dhe didaktik; aspektin gjuhësor dhe visual/ ilustrimet; Lidhjet me aspektet edukim për pjekuri, edukim për demokraci, edukim paqësor;

---

<sup>118</sup> Avokati i Popullit, në mes tjerash, ka shprehur qëndrimin e tij lidhur me këtë në Raportin me Rekomandime Ex Officio nr. 441/2018 në lidhje me tri parimet e përgjithshme për interpretimin e akteve normative dhe zbatimin e këtyre parimeve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ku ka konstatuar se parimi *lex specialis* i jep përparësi dispozitës së Ligjit për Personat e Verbër kundrejt dispozitës së Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

<sup>119</sup> Në librin e Biologjisë të klasave të 10-ta të Gjymnazit Gjuhësor, si dhe në librin e klasave të 11-ta të Gjymnazit të Përgjithshëm, Sindroma Down cilësohet si idiotia mongoloide, term i cili sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) ka vite që nuk përdoret dhe cilësohet si term fytes. Në këto libra të Biologjisë po ashtu theksohet se personat me sindromën Down jetojnë më së shumti 10 deri në 15 vjet, gjë e cila nuk është e vërtetë. Ta kemi parasysh që tekstet që përdoren aktualisht janë hartuar pas luftës, shumë para zhvillimit të standardeve për tekste shkollore.

reflektimin e barazisë gjinore dhe standardet plotësuese sipas lëndëve ( gjëra këto të përcaktuara në Standardet për tekset shkollore dhe ligjin për tekset shkollore).

Këshilli i ekspertëve të programeve të teksteve shkollore (i themeluar në 2-3 vitet e fundit) në kuadër të MASHTI, tashmë ka zhvilluar aktivitete e veta duke krijuar bazën e dokumenteve për procesin e hartimit të teksteve të reja shkollore. Kjo lë të kuptohet që tekset e vjetra do të largohen nga përdorimi. Mbetet që ky Këshill dhe mekanizmi përgjegjës në MASHT të sigurojnë zbatimin e standardeve të teksteve shkollore, ashtu që tekset t'i kemi cilësore pa elemente diskriminuese.

Këshilli i ekspertëve të programeve të teksteve shkollore, në kuadër të MASHTI, duhet të merret me adresimin e shqetësimeve të evidentuara nga Avokati i Popullit, Agjensioni për Barazi Gjinore, si dhe Organizatat Joqeveritare lidhur me përmbajtjen dhe eliminimin e elementeve (gjuhës) diskriminuese të identifikuar në tekset shkollore<sup>120</sup>.

**Diskriminimi ndaj personave që i takojnë komunitetit LGBTI-** Komunitetet LGBTI, si pjesë e shoqërisë në Kosovë, konsiderohen të jenë kategori e marginalizuar edhe përkundër faktit se ekziston kornizë ligjore e cila i mbron të drejtat e tyre. Personat LGBTI ende jetojnë me frikë për ta shprehur orientimin e tyre seksual, për shkak të qasjes dhe homofobisë së shoqërisë ndaj tyre, dhe kjo është arsyeja që ata janë të diskriminuar në jetën e përditshme. Sa i përket legjislacionit i cili rregullon të drejtat e personave LGBTI, është evidente që nuk mbetet asnjë zbrazëti në legjislacionin ekzistues që kërkon plotësim lidhur me mbrojtjen e mëtejshme të të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, mirëpo problemi qëndron në faktin se legjislacioni përkatës në këtë fushë nuk zbatohet në mënyrë adekuate. Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, në kuptim të nenit 1, e parasheh parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, përfshirë identitetin gjinor dhe orientimin seksual. Ligji për Familjen përcakton martesën si bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, konform legjislacionit në fuqi. Ndërsa, Ligji për Gjendjen Civile nuk e ndalon ndryshimin e gjinisë/seksit në dokumentet zyrtare, procedurat për ta bërë këtë nuk ekzistojnë. Megjithatë, edhe sot nuk ka ndonjë bazë ligjore e cila do të mundësonte që qytetarët, mbi bazën e së drejtës në identitet gjinor të garantuar me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, të kenë mundësi të kërkojnë ndërrimin e shënjeshtës së gjinisë.


**Diskriminimi i pjestarëve të komuniteteve që nuk janë shumicë,** duke përfshirë komunitetet serbe, rome, ashkali, egjiptiane, turke, boshnjake, gorane, kroate dhe malazeze, ballafaqohen me nivele të ndryshme të diskriminimit institucional dhe shoqëror në punësim, arsim, shërbime sociale, përdorim gjuhësor, liri të lëvizjes, për t'u kthyer në shtëpitë e tyre (për personat e zhvendosur)<sup>121</sup> dhe të drejta të tjera themelore.

<sup>120</sup> ABGJ me MASH kanë hartuar manualin për përfshirjen e perspektivës gjinore në tekset shkollore. Zyra për Qeverisje të Mirë ka hartuar Udhëzuesin për identifikimin e diskriminimit në tekset shkollore në bazë të gjinisë dhe orientimit seksual.

<sup>121</sup> Për të marrë zgjidhje të qëndrueshme në vendin e origjinës, vendndodhjen e preferuar të kthimit ose për t'u integruar në vendet tyre të zhvendosjes, Ministritë e linjës duhet të mbështesin MKK-në në strategjinë potenciale të mobilizimit të donatorëve për një projekt rajonal mbi zgjidhjet e qëndrueshme nën fushëveprimin e Iniciativës Ndërinstitucionale mbi Zgjidhjet e Përhershme për Personat e Zhvendosur nga Kosova ("Procesi i Shkupit"). Disa baza për nevojat ekzistuese janë përshkruar tashmë në dy raportet "Situata dhe nevojat e personave të zhvendosur të brendshëm" dhe "Personat e zhvendosur nga Kosova në rajon - Rivlerësimi i interesit për kthim". "Përveç kësaj, mekanizmi i "Procesit të Shkupit" është pjesë e Planit të Qeverisë për zbatimin e pikës 12 të Marrëveshjes së Uashingtonit".

Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve ka vënë në dukje diskriminimin në punësim në sektorin publik në pothuajse të gjitha institucionet vendore. Megjithëse ligji parashikon që 10% e punonjësve në nivel lokal dhe kombëtar të Qeverisë të jenë anëtarë të pakicave, përfaqësimi i tyre mbetet i kufizuar dhe përgjithësisht i kufizuar në pozita të nivelit të ulët. Komunitetet më të vogla, si goranët, romët, ashkallitë dhe egjiptianët, janë veçanërisht të nënpërfaqësuar. Nuk kishte mjete juridike për t'i adresuar këto shqetësime. Pjestarët e komuniteteve që nuk janë shumicë, mbeten dobët të përfaqësuar në institucionet publike qendrore<sup>122</sup>.

**Diskrimini në aspektin e përdorimit të gjuhës-** Zyra e Komisionerit për gjuhët, institucion i mandatuar për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e të drejtave gjuhësore, gjatë vitit 2018 ka pranuar njëzet e tri (23) ankesa, lidhur me pretendimet për shkelje të Ligjit nga institucionet<sup>123</sup>:



Gjithashtu, Komiteti Këshilldhënës i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKMPK), thekson se mosrespektimi i legjislacionit nuk ndodh vetëm si rezultat i mungesës së resurseve financiare, teknike dhe njerëzore, por ka edhe arsye të tjera më të thella, siç është vetëdijesimi i kufizuar i autoriteteve për obligimin ligjor dhe mungesa e vullnetit të tyre për futjen e aspektit të gjuhëve në të gjitha politikat, mosekzistimi i mundësisë për mësimin e të dyja gjuhëve zyrtare njëkohësisht gjatë shkollës fillore dhe të mesme, si dhe i studimit të tyre në nivel universitar, mungesës së drejtimeve në shkollimin universitar nga fusha e përkthimeve dhe trajnimeve të shërbyesve civilë. Komisioni këshilldhënës përkujton rëndësinë e gjithanshme që ka të mësuarit dhe njohja e gjuhëve për arritjen e shoqërisë përfshirëse dhe shmangien e rrezikut që komunitetet e ndryshme të funksionojnë paralelisht<sup>124</sup>, mungesa e mbishkrimeve brenda dhe jashtë objekteve komunale, mungesa e emërtimit të rrugëve në dy gjuhët zyrtare, përkthimi i web faqeve komunale në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar.

**Të drejtat pronësore dhe trashëgimore të grave** - Shfrytëzimi dhe e drejta për të zotëruar pronën mbetet faktor i rëndësishëm për fuqizimin ekonomik të gruas. Sundimi i ligjit në Kosovë karakterizohet me të

<sup>122</sup> Shih Raporti i Vendi për Kosovën i Komisionit Evropian 2018.

<sup>123</sup> [http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/Raporti\\_Vjetor\\_2018.pdf](http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2018.pdf)

<sup>124</sup> Shih, Komisioni këshilldhënës i konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, Opinioni i katërt për Kosovën - miratuar më 8 mars 2017, fq.29.



drejta pronësore të definuara dhe të zbatuara dobët, sidomos të drejtat pronësore të femrave dhe grupeve minoritare. Zbatimi i mangët i ligjeve ekzistuese, ligjeve kryesore që rregullojnë blerjen, bartjen dhe tjetërsimin e pronës private, si: Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, Ligji për Familjen i Kosovës (ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen të Kosovës nr. 2004/3213), Ligji për Trashëgiminë (ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë). Faktorët që çojnë në zbatimin e dobët të këtyre ligjeve mund të përfshijë (i) njohjen e pamjaftueshme të mjeteve juridike, (ii) funksionalitetin e dobët të mekanizmave institucionalë në lidhje me gëzimin e të drejtave pronësore, dhe (iii) qëndrueshmëria e disa barrierave kulturore të cilat i pengojnë gratë nga gëzimi i plotë dhe i barabartë i të drejtave të tyre pronësore. Në vitin 2016, gratë posedonin vetëm 18% të pasurisë së patundshme në Kosovë, duke përfshirë edhe tokën<sup>125</sup>.

Bazuar nga ankesat e parashtruara në IAP, kjo dukuri është e shprehur më së shumti në zonat rurale, por nuk ndryshon shumë situata edhe në zonat urbane. Në shumicën e rasteve vetëm burrat janë subjekt i së drejtës në trashëgimi, përderisa gratë në shumicën e rasteve heqin dorë nga kjo e drejtë. Vlerësohet se rreth 19% e grave heqin dorë nga të drejtat e tyre pronësore ose të trashëgimisë. Faktorët që kontribuojnë që gratë të heqin dorë nga e drejta e tyre për pronë ose trashëgimi përfshijnë: frikën e bartjes së pronës së familjes ku kanë lindur te familja e bashkëshortit të tyre (12%); dhe arsye të tjera (18%), të tilla si: “unë nuk dua hise nga prindërit e mi”; “unë dua të krijoj pasuri me familjen time/me familjen e burrit”; “dëshirë personale”; dhe “mundësia e krijimit të armiqësisë në familje”<sup>126</sup>. Kjo situatë dikton nevojën të punohet edhe më shumë në ndërgjegjësimin e grave, ashtu edhe burrave, lidhur me të drejtat e tyre trashëgimore. Përmirësimi i klimës shoqërore dhe institucionale për mbështetjen e grave në këtë sfidë ligjore dhe sociale konsiderohet si pikënisje e zhvillimeve pozitive për realizimin e të drejtave pronësore dhe trashëgimore<sup>127</sup>. Shkalla e ulët e zotërimit të pronës krijon probleme të ndryshme ekonomike dhe sociale për gratë të tilla si mospasja e kolateralit të mjaftueshëm për hua, ose mospasja e mundësisë për të realizuar të drejtat pas vdekjes së bashkëshortit ose shkurorëzimit. Pa të drejta pronësore, gratë mund të qëndrojnë në martesë të vështira, duke pasur frikë se shkurorëzimi mund t’i bëjë ato të pastreha<sup>128</sup>.

Në këtë vend, vlen të përmendet se ka pasë efekte pozitive aprovimi i Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e pronës se përbashkët në emrin e të dy bashkëshortëve.

---

<sup>125</sup> Hulumtimi mbi të Drejtat Pronësore dhe trashëgimore të Grave, nga Qendra “CLARD, Prishtinë, Mars-2017.

<sup>126</sup> Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, Analiza Gjinore e Kosovës, 2018.

<sup>127</sup> Pakoja ligjore (1. LIGJI Nr. 06/L-007 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-007 PËR PROCEDURËN JOKONTESIMORE, GZ Nr. 22 /18 DHJETOR 2018; 2. LIGJI Nr. 06/L-008 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/26 PËR TRASHËGIMINË NË KOSOVË, GZ, Nr. 22 / 18 DHJETOR 2018; dhe 3. LIGJI Nr. 06/L-010 PËR NOTERINË, GZ. Nr. 23 /26 DHJETOR 2018) ka adresuar rekomandimet që ndërlihen me SKDP-në, përkatësisht me këto ndryshime ligjore është forcuar roli i gruas në trashëgimi, duke siguruar që në rast të heqjes dorë nga trashëgimia, organi vendimmarrës (gjykata apo noteri) të sigurohet që kjo heqje dorë është bërë në pajtim me vullnetin e lirë të tyre. Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për të drejtat pronësore parasheh disa masa të cilat synojnë të adresojnë dhe rregullojnë të drejtën në trashëgimi të grave. Masa 3.1 kërkon njohjen e njëtrajtshme të bashkësive martesore me qëllim që të sigurohet e drejta në trashëgimi e grave. Masa 3.2 parashesh zhvillimin e masave mbrojtëse për rastet e heqjes dorë dhe përjashtimit nga trashëgimia. Kjo masë synon që çdo kush që heq dorë nga trashëgimia të informohet dhe të shmangët detyrimi për një gjë të tillë.

<sup>128</sup> Women for Women, “Kosova i bashkohet Koalicionit Kombëtar për të Drejtat Pronësore”, në: <https://www.womenforwomen.org/blog/kosovo-joins-national-property-rights-coalition>, qasur më 30 maj 2018.

Derisa në vitin 2015 regjistrimi ishte i ulët, sipas të dhënave kadastrale në vitin 2015, në 28 komuna të vendit ishin regjistruar 156 prona në emrin e përbashkët, ndërsa dy vite më vonë, më 2017, shuma ishte rritur në 1907 prona të regjistruara në emër të grave apo të dy bashkëshortëve.

### **Diskriminimi i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës**

Për më shumë se një dekadë, viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës kanë qenë të diskriminuara dhe anashkaluara nga ana institucionale. Në nëntor të vitit 2017, qeveria themeloi Komisionin Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës dhe ndau resurset buxhetore për pensionet e viktimave. Që prej shkurtit 2018, viktimat mund të aplikojnë për njohje dhe verifikim, për të marrë beneficinet individuale. Periudha kohore e ligjit në fjalë përjashton ata që kanë përjetuar dhunë seksuale të ndërlidhur me konfliktin pas 20 qershorit 1999<sup>129</sup>.

Pavarësisht nga këto zhvillime të rëndësishme, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut i inkurajon autoritetet që të ndërmarrin hapa të mëtejshëm për të siguruar që këto viktime të mund të rindërtojnë plotësisht jetën e tyre dhe të kapërcejnë stigmën, duke filluar me përfshirjen e tyre në zhvillimin e politikave dhe masave që i prekin ato. Rekomandimet<sup>130</sup> përkatëse nga UN Women<sup>131</sup>, të cilat Komisari i mbështet, japin udhëzime të dobishme në këtë drejtim.

Me njohjen e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës dhe realizimit të së drejtës në pensionin personal, nuk mund të themi se është përfunduar misioni. Përkundrazi, më tutje duhet angazhuar ashtu që kësaj kategorie t'i ofrohet sigurim dhe shërbim shëndetësor i mirëfilltë, t'i ofrohet punësim e aftësim profesional, arsimim kualitativ dhe rehabilitim. Përfundimisht, avancimi i zbatimit të ligjeve, politikave dhe planeve vendore, të cilat kanë për qëllim t'i përmbushin nevojat e të mbijetuarave të dhunës seksuale të ndërlidhur me periudhën e luftës në Kosovë, do të jetë prioritet për Qeverinë e Kosovës.

---

<sup>129</sup> Shih , Raporti për Vendin i Komisionit Evropian për Kosovën 2018, fq.18.

<sup>130</sup> Technical Report-The conflict did not bring us floëers, pg.49-UN WOMEN.

<sup>131</sup> Shiko, Memorandumin pas misionit të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës në Kosovë nga data 5 deri më 9 shkurt 2017, fq.6.

## 5.0 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, përcakton Objektivat strategjike dhe ato specifike, të cilat synohet të arrihen brenda një periudhe pesë vjeçare. Fushat prioritare të përzgjedhura janë të bazuara në përmbushjen e rekomandimeve dhe kërkesave të evidentuara në vazhdimësi nga Komisioni Evropian në Raportet për Vendin ndër vite, IAP si dhe institucioneve tjera relevante vendore e ndërkombëtare, për përmirësimin e bashkëveprimit dhe koordinimit ndërinstytucional, zbatimit efektiv të ligjeve, politikave dhe standardeve ndërkombëtare e rajonale për të drejtat e njeriut.

Që të arrihet synim i Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut janë caktuar objektivat strategjike me objektivat specifike, si:

### 5.1 Objektiva strategjike #1:

#### **Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar të drejtat e njeriut**

Qeverisja e mirë, transparenca dhe llogaridhënia institucionale janë faktorë kyq për mbrojtje efektive dhe efikase të të drejtave të njeriut dhe zbatimit të ligjeve. Të drejtat e njeriut nuk mund të realizohen plotësisht pa zbatim efektiv të legjislacionit, politikave, standardeve ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, pa koordinim të mirëfilltë ndërinstytucional, pa mekanizma qeverisës efektiv, transparent dhe të përgjegjshëm. Prandaj, arritja e objektivës së parë strategjike, konsiderohet se është thelbësore në realizimin e të drejtave të njeriut, arrijten në mënyrë efektive të një game të gjerë të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe funksionalizimin dhe fuqizimin e sistemit të monitorimit dhe mekanizmave institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në kontekst të avancimit të monitorimit, vlerësimit dhe zbatimit të politikave dhe kornizës ligjore.

Në funksion të arritjes së kësaj objektivë Qeveria, krahas përpjekjeve për avancimin e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional, do t'i mobilizojë resurset e nevojshme njerëzore dhe buxhetore për fuqizimin e mekanizmave institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut<sup>132</sup>; zbatimin e ligjeve, politikave në kuadër të sektorit të shërbimeve publike, *avancimin e sistemit të monitorimit të zbatimit të drejtave të njeriut me tregues të matshëm, me të dhëna relevante, kualitative, të qasshme, të besueshme dhe të zbrërthyer sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, racës, përkatësisë etnike, vendodhjes gjeografike*<sup>133</sup> dhe karakteristikave tjera të rëndësishme, i cili do të shërbente si mekanizëm referimi për të gjitha institucionet politikbërëse gjatë procesit të vlerësimit të nevojave për orientimin dhe hartimin e politikave në fusha dhe sektorë të

---

<sup>132</sup> , Dokumenti Strategjik për Kosovën i Komisionit Evropian (2014-2020) nënvizon që, "strukturat që merren me mbrojtjen, promovimin dhe raportimin mbi të drejtat e njeriut duhet të jenë të efektshme, funksionale si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, gjithashtu deri në vitin 2020, korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve duhet të zbatohet në mënyrë efektive.

<sup>133</sup> UN 2915, Sustainable Development Goals (SDGs)-Agenda 2030.

ndryshëm të të drejtave të njeriut. Po ashtu, i njëjti do shërbente si sistem referues gjatë procesit të përgaditjeve të raporteve për mekanizmat ndërkombëtarë të cilët monitorojnë zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Një rol shumë të rëndësishëm në tërë këtë proces i cili kërkon përkushtim dhe koordinim të mirëfilltë institucional, do ta ketë Grupi Koordinues Ndërmintrosor për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës, i cili udhëhiqet nga Kryeministri i vendit.

#	Objektiva strategjike	Objektivi Specifik	
1	Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut	1.1	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i mekanizmave institucionalë efektivë, të përgjegjshëm, gjithëpërfshirës, pjesëmarrës dhe të përgjegjshëm, në të gjitha nivelet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut;</li> </ul>
		1.2	<ul style="list-style-type: none"> <li>Avancimi i mbledhjes së të dhënave për të drejtat e njeriut, monitorimit dhe raportimit;</li> </ul>
		1.3	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e transparencës dhe lehtësimi i qasjes në informata dhe dokumente publike;</li> </ul>
		1.4	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi efektiv i të drejtave të njeriut siç garantohet nga Korniza kushtetuese dhe legjislative e Kosovës dhe instrumentet direkt të zbatueshme ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut.</li> </ul>

## 5.2 Objektiva strategjike #2:

### Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut;

Një prej kushteve themelore për zhvillimin e një sistemi funksional të sundimit të ligjit është respektimi i standardeve për të drejtat e njeriut nga institucionet shtetërore. Çdo nënpunës publik konform Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi, është i obliguar ti përmbahet, zbatojë dhe promovojë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve. Ato standarde janë relevante si për cilësinë e ligjeve dhe politikave, po ashtu edhe për zbatimin e tyre. Qeveria e Kosovës përmes kësaj objektivë synon të promovojë dhe zbatojë një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, të vendos një kulturë administrative institucionale në të gjitha resorët e qeverisë, ku respektimi, mbrojtja, promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut bëhet pjesë e kulturës së përgjithshme të punës të çdo zyrtari që ushtron funksione publike dhe ofron shërbime publike për qytetarin.

Në funksion të arritjes së kësaj objektivë, Qeveria e Kosovës do ti jap prioritet zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga mekanizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë për të drejtat e njeriut, organizatave si dhe mekanizmave vendorë, zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, fuqizimin e sistemit kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (SKMPDNJ), ofrimit të mundësive të barabarata dhe trajtim të barabartë, parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi përmes krijimit të mundësisë që Administrata të krijojë politika publike të cilat kanë për synim përmirësimin e situatës së komuniteteve të marginalizuara me anë të masave afirmative, krijimit dhe fuqizimit të sistemit të trajnimit për të drejtat e njeriut, fushata edukimi dhe vetëdijësimi për të drejtat e njeriut. Objektiva strategjike është në përputhje dhe do të kontribuojë në realizimin e qëllimeve kryesore të Agjendës që bën thirrje për zhdukjen e varfërisë në të gjitha format dhe eliminimin e pabarazive (OZHQ) 6 dhe 10 (në veçanti 10.2 dhe 10.3)

#	Objektiva strategjike	Objektivi Specifik	
2	Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut	2.1	Fuqizimi i sistemit kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (SKMPDNJ)
		2.2	Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i diskriminimit
		2.3	Krijimi dhe fuqizimi i sistemit të trajnimit për standardet e të drejtave të njeriut

### 5.3 Objektiva strategjike #3 :

#### Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë

Përpyekjet globale për të ndërtuar një botë të barabartë janë bërë prioritet kyq i agjendës së Kombeve të Bashkuara, në kuadër të së cilës është përcaktuar një synim i dedikuar zvogëlimit të pabarazive (SDGs 10)<sup>134</sup>. Objektiva strategjike është në përputhje me këtë dhe do të kontribuojë në qëllimin kryesor të Agjendës 2030 që bën thirrje për zhdukjen e varfërisë në të gjitha format dhe eliminimin e pabarazive (SDGs 1<sup>135</sup>, dhe SDGs 10<sup>136</sup>), shërbime kualitative shëndetësore dhe sociale (SDGs 2<sup>137</sup> dhe SDG3<sup>138</sup>), ambient të shëndetshëm dhe siguri ushqimore (SDGs 15<sup>139</sup>, dhe SDGs 12<sup>140</sup>). Qeveria do të miratojë ligje të reja me synimin të plotësojnë legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në ato fusha ku ka nevojë.

Reformat, avancimi dhe zbatimi i kornizës ligjore e të politikave në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare do ta avancojë dukshëm mirëqenien e qytetarëve të Kosovës. Ky objektivi do të jetë në funksion të përmirësimit të shërbimeve sociale, familjare dhe shëndetësore e cila synon fuqizimin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe ofrimin e qasjes në shërbime sociale dhe familjare përmes përfundimit të reformave në skemën e ndihmës sociale; harmonizimit dhe avancimit të kornizës ligjore në fushën e shërbimeve sociale dhe shërbimeve shëndetësore nëpërmjet përcaktimit të sistemit të qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale dhe zbutjen e varfërisë; krijimin e fondit të sigurimeve shëndetësore, ofrimin e shërbimeve dhe programeve për popullatat kyqe vartës nga alkooli dhe droga, personave me HIV-AIDS, personave të prekur nga Tuberkulozi (TBC) etj, si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe garantimin e sigurisë së

<sup>134</sup> UN.2015. Sustainable Development Goals (SDGs) – Agenda 2030.

<sup>135</sup> Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj në secilin vend;

<sup>136</sup> Ulja e pabarazisë në kuadër të shtetit dhe midis shteteve;

<sup>137</sup> Zhdukja e urisë, të arrihet sigurimi i ushqimit dhe të ushqyerit e përmirësuar si dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme;

<sup>138</sup> Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë për të gjitha moshat;

<sup>139</sup> Mbroni, rivendosni dhe promovoni përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, në mënyrë të qëndrueshme menaxhimin e pyjeve, luftimin e shkretëtirës dhe ndalimin dhe prishjen e degradimit të tokës humbja e biodiversitetit

<sup>140</sup> Sigurimi i konsumit të qëndrueshëm dhe modeleve të prodhimit;

ushqimit. Gjithashtu, ky objektiv një ndikim të veçantë do ta ketë në garantimin dhe zbatimin e të drejtave të punëtorëve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

**Për arritjen/përmbushjen e objektivës strategjike, janë paraparë këto objektiva specifike:**

#	Objektiva strategjike	Objektivi Specifik	
3	Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë	3.1	<ul style="list-style-type: none"> <li>Harmonizimi i kornizës ligjore me Konventën për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK);</li> </ul>
		3.2	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ngritja e kapaciteteve dhe vetëdijes shoqërore dhe institucionale për mbrojtjen e mjedisit;</li> </ul>
		3.3	<ul style="list-style-type: none"> <li>Garantimi dhe zbatimi i të drejtave të punëtorëve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare;</li> </ul>
		3.4	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i programeve për rehabilitimin dhe trajtimin e popullatave kyqe.</li> </ul>

#### 5.4 Objektiva strategjike #4 : Lehtësimi i qasjes në sistemin e drejtësisë

Qeveria e Kosovës i bashkohet aspiratave të të gjitha shteteve palë në kuadër të OKB-së, që njëherit është edhe objektiva e 16-të e synimeve për zhvillim të qëndrueshëm, të mobilizohen për promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse, për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë dhe për të ndërtuar institucione efektive, të përgjegjshme llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e qeverisjes<sup>141</sup>.

Pavarësisht progresit në zgjidhjen dhe zvogëlimin e lëndëve të vjetra, ende më shumë se 200.000 mijë lëndë të vjetra vazhdojnë ta ngarkojnë sistemin gjyqësor dhe kjo i pengon qytetarët për të pasur një qasje të shpejtë në drejtësi. Sa i përket numrit total të lëndëve gjyqësore, problematikë mbetet vetëm çështja e lëndëve të trashëguara, e cila deri me 01.01.2019 kanë qenë 245559, ndërsa sa i përket lëndëve të reja të zgjidhura, del se në 9 mujorin e parë të vitit 2019 janë pranuar 82521 lëndë të reja, janë zgjedhur 108004, ndërsa të pazgjidhura janë 219922 lëndë, që nënkupton se 10.44% ka rritje të reduktimit të lëndëve. Përmes promovimit të ndërmjetësimit, do tentohet të ndikohet në uljen e numrit të lëndëve në gjykata. Po ashtu, Qeveria do të ndajë buxhet të mjaftueshëm për qasjen në drejtësi të viktimave të krimit, për ofrimin e ndihmës juridike falas për të gjitha grupet në nevojë konform legjislacionit në fuqi, duke përfshirë edhe personat e zhvendosur, si dhe kategoria e banorëve të përhershëm (lindje të paregjistruara) që nuk mund të provojnë nënshtetësinë e Kosovës duhet të përfshihen në sistemin e ndihmës juridike falas (aktualisht UNHCR-ja ofron ndihmë juridike për marrjen e shtetësisë). Të gjithë hapat e planifikuar do të jenë në harmoni me Strategjinë e miratuar për Sundimin e Ligjit.

<sup>141</sup> UN 2015. Sustainable Development Goals (SDGs) – Agenda 2030;

Më tutje, do të mbështeten fushatat e shtrirjes së informimit publik mbi qasjen në drejtësi nëpërmjet realizimit të drejtës për kompensim për viktimat e krimit, ndërmjetësimit, ndihmës juridike falas, për të informuar individët mbi të drejtat e tyre ligjore dhe për të lehtësuar kërkimin e ndihmës, veçanërisht duke vënë në shënjestër individët në zonat rurale dhe komunitetet jo shumicë në mënyrë që merr parasysh aspektin gjinor.

**Për arritjen/përbushjen e objektivës strategjike, janë paraparë këto objektiva specifike:**

#	Objektiva strategjike	Objektivi Specifik	
4	Lehtësimi i qasjes në sistemin e drejtësisë	4.1	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e efikasitetit të trajtimit të lëndëve nga gjykatat dhe prokuroritë;</li> </ul>
		4.2	<ul style="list-style-type: none"> <li>Funksionimi i sistemit të ndërmjetësimit;</li> </ul>
		4.3	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përmirësimi i zbatimit të drejtës për ndihmë juridike falas;</li> </ul>
		4.4	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lehtësimi i barrierave për mbrojtjen e viktimave të krimit, në veçanti për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje;</li> </ul>
		4.5	<ul style="list-style-type: none"> <li>Realizimi i të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave, të drejtave pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve.</li> </ul>

## **6.0 MEKANIZMI RAPORTUES DHE MONITORUES PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT**

**Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të përbën** dokumentin themelor të politikave për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut .

Në përputhje me qëllimet dhe objektivat specifike të përcaktuara në Programin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, Plani i Veprimit reflekton dhe përcakton masat specifike dhe konkrete për secilin institucion përgjegjës, së bashku me tregues suksesi të matshëm, duke përfshirë “treguesit me ndjeshmëri gjinore” dhe periudhë kohore të qartë, si dhe një buxhet të përafërt për mbulimin e aktiviteteve.

Zyra e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të Mirë është organi i ngarkuar, i cili në bashkëpunim dhe bashkëkoordinim me institucionet e tjera, do të koordinojë procesin e zbatimit, të raportojë dhe monitorojë zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Për më tepër, Zyra për Qeverisje të Mirë është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të masave të përcaktuara në Planin e Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut). Institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Planin të Veprimit, do të raportojnë tek Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës- Zyra për Qeverisje të Mirë dhe të Drejtat e Njeriut në periudha 6 mujore dhe pavarësisht, sipas nevojave dhe kërkesës të drejtuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë.

### **6.1 Mekanizmat zbatues**

Të gjitha institucionet qeveritare, qendrore dhe lokale, obligohen të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Programin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe në Planin e Veprimit për zbatimin e programit ndër vite, në përputhje me përgjegjësitë dhe mandatin ligjor të tyre.

### **6.2 Mekanizmat monitorues**

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Programin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut si dhe aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.

Dy mekanizmat kryesorë përgjegjës për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin për zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut janë: Grupi Koordinues Ndërmintrosor për të drejtat e njeriut dhe Zyra për Qeverisje të Mirë. Roli i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit është për të koordinuar, monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë pro aktive përmbushjen e aktiviteteve dhe objektivave të Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut), si dhe për të përcaktuar nëse zhvillimet, rezultatet dhe planet janë përmbushur në mënyrë që të mund të ndërmerren veprime parandaluese për t'i përmirësuar mangësitë. Përgjegjësia për bashkërendimin e monitorimit dhe raportimit i takon ZQM/ZKM-së, përderisa përfshirja e vazhdueshme e shoqërisë civile, Avokatit të Popullit dhe Organizatave ndërkombëtare në këtë proces do të sigurohet përmes punës monitoruese dhe këshilluese në



kuadër të Grupit Koordinues Ndërmistror për të Drejtat e Njeriut, apo në mënyrë plotësisht të pavarur. ZKM/ZQM-ja duhet të raportojë mbi progresin në zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe Planit të saj të Veprimit në baza vjetore dhe gjashtë mujore konform procedurave ligjore në fuqi. Raporti vjetor i progresit do të përgatitet deri në fund të çerekut të parë të vitit vijues. Matrica për Monitorim dhe Raportim do të përdoret për të monitoruar dhe vlerësuar përparimet në zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriu (2021-2025). Ky sistem do të përbëhet nga “treguesit e bazuar në performancë” të cilët janë dizajnuar për të matur rezultatet dhe nivelin e ndikimit që Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut do të ketë në praktikë.

## 7.0 Ndikimet Financiare në Implementimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut

Plani i Veprimit për zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut ka një kosto totale të zbatimit prej **1,241,275** euro për tri vite të zbatimit (2021-2023). Pjesa më e madhe e kostos (rreth 95% e buxhetit) do të përdoret për shpenzimet rrjedhëse që lidhen me ngritjen e kapaciteteve, rregullimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit.

**Tabela 1.** jep një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas viteve, ndërsa kjo bazohet në kalkulime të detajuara të shpenzimeve për secilën objektivë të planifikuar, ndërsa tabela 2 jep një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas burimeve të financimit.

Zbatimi i Planit të Veprimit për 3 vitet e para do të kërkojë mjete financiare siç tregohet në tabelën më poshtë në milionë euro (KT- Buxheti i përgjithshëm për Planin e Veprimit, KR- kostot rrjedhëse, K - kapital kapitale, SG - subvencionet dhe grantët).

**Tabela 1.** Përmbledhja e buxhetit sipas objektivave dhe viteve

Objektivat Strategjike	2021				2022				2023			
	KT	KR	K	SG	KT	KR	K	SG	KT	KR	K	SG
Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut	44,700	44,700	0	23,000	111,900	111,900	0	59,000	41,900	41,900	0	19,000
Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut;	114,425	114,425	0	60,970	117,925	117,925	0	61,470	74,425	74,425	0	28,470
Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë;	108,500	108,500	0	56,500	204,000	204,000	50,000	107,000	107,000	107,000	0	41,000
Lehtësimi i qasjes në Sistemin e Drejtësisë	101,000	101,000	0	54,000	114,500	114,500	0	63,500	101,000	101,000	0	55,000
<b>Totali:</b>	<b>368,625</b>				<b>548,325</b>				<b>324,325</b>			
<b>Nën-totali 2021-2023:</b>	<b>1,241,275 euro</b>											

**Tabela 2. Struktura e shpenzimeve sipas viteve të planifikuara në plan të veprimit dhe burimit të financimit**

Vitet	Shpenzime totale		
	BRK	Donatorët	Total:
2021	234,155	134,470	368,625
2022	307,355	240,970	548,325
2023	180,855	143,470	324,325
<b>Total:</b>	<b>722,365</b>	<b>518,910</b>	<b>1, 241, 275</b>

**Tabela 3. Struktura e shpenzimeve për dy vitet e fundit të programit dhe burimit të financimit**

Vitet	Shpenzime totale		
	BRK	Donatorët	Total:
2024	190,313	90,000	280,313
2025	100,122	104,700	204,822
<b>Total:</b>	<b>290,435</b>	<b>194,700</b>	<b>485,135</b>

## 8.0 Ndërlidhja e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut me SDG

### (Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm)

#	Objektiva strategjike	Objektivi Specifik		SDG (Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm)
1	Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut	1.1	Zhvillimi i mekanizmave institucionalë efektivë, të përgjegjshëm, gjithëpërfshirës, pjesëmarrës dhe të përgjegjshëm, në të gjitha nivelet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut ;	<p>SDG 1. Fundi i varfërisë, në të gjitha format e saj, kudo.</p> <p>SDG 2. Fundi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqimit dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme.</p> <p>SDG 3. Siguroni jetë të shëndetshme dhe promovoni mirëqenien për të gjithë në të gjitha moshat.</p> <p>SDG 4. Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p> <p>SDG 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.</p> <p>SDG 6. Siguroni disponueshmërinë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë.</p> <p>SDG 11. Bëni qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike dhe të qëndrueshme.</p> <p>SDG-ve 8. Punë e denjë për të gjithë dhe rritje ekonomike.</p> <p>SDG 10. Zvogëlimi i pabarazive.</p> <p>SDG 16. Promovoni shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm.</p> <p>SDG 17. (partneritete), të cilat janë gjithashtu të rëndësishme për këtë objektiv.</p>
		1.2	Avancimi i mbledhjes së të dhënave për të drejtat e njeriut, monitorimit dhe raportimit;	
		1.3	Rritja e Transparencës dhe lehtësimi i qasjes në informata dhe dokumente publike;	
		1.4	Zbatimi efektiv i të drejtave të njeriut siç garantohet nga Korniza kushtetuese dhe legislative e Kosovës dhe instrumentet direkt të zbatueshme ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut.	
#	Objektiva strategjike	Objektivi Specifik		SDGs
2	Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut	2.1	Fuqizimi i sistemit kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (SKMPDNJ);	<p>SDG 1. Fundi i varfërisë, në të gjitha format e saj, kudo.</p> <p>SDG 2. Fundi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqimit dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme.</p> <p>SDG 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.</p> <p>SDG 4. Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p> <p>SDG 10. Zvogëlimi i pabarazive</p> <p>SDG 16. Promovoni shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm.</p> <p>SDG 17. (partneritete), të cilat janë gjithashtu të rëndësishme për këtë objektiv.</p> <p>SDG 8. Promovoni rritje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike, punësim të plotë dhe produktiv</p>
		2.2	Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i diskriminimit;	
		2.3	Krijimi dhe fuqizimi i sistemit të trajnimit për standardet e të drejtave të njeriut.	

#	Objektiva strategjike	Objektivi Specifik	SDGs
			dhe punë të denjë për të gjithë.
3	Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë	<p>3.1 Harmonizimi i kornizës ligjore me Konventën për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDSEK);</p> <p>3.2 Ngritja e kapaciteteve dhe vetëdijes shoqërore dhe institucionale për mbrojtjen e mjedisit;</p> <p>3.3 Garantimi dhe zbatimi i të drejtave të punëtorëve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare;</p> <p>3.4 Zhvillimi i programeve për rehabilitim dhe trajtimin e popullatave kyçe .</p>	<p><b>SDG 1.</b> Fundi i varfërisë, në të gjitha format e saj, kudo.</p> <p><b>SDG 2.</b> Fundi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqimit dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme.</p> <p><b>SDG 3.</b> Siguroni jetë të shëndetshme dhe promovoni mirëqenien për të gjithë në të gjitha moshat.</p> <p><b>SDG 4.</b> Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p> <p><b>SDG 8.</b> Promovoni rritje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.</p> <p><b>SDG 10.</b> Zvogëlimi i pabarazive.</p> <p><b>SDG 13.</b> Veprimi klimatik.</p> <p><b>SDG 16.</b> Promovoni shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm.</p>
#	Objektiva strategjike	Objektivi Specifik	SDGs
4	Lehtësimi i qasjes në Sistemin e Drejtësisë	<p>4.1 Rritja e efikasitetit të trajtimit të lëndëve nga gjykatat dhe prokuroritë;</p> <p>4.2 Funkionimi i Sistemit të ndërmjetësimit;</p> <p>4.3 Përmirësimi i zbatimit të drejtës për ndihmë juridike falas;</p> <p>4.4 Lehtësimi i barrierave për mbrojtjen e viktimave të krimit në veçanti për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje;</p> <p>4.5 Realizimi i të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave, të drejtave pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve.</p>	<p><b>SDG 8.</b> Promovoni rritje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.</p> <p><b>SDG 10.</b> Zvogëlimi i pabarazive</p> <p><b>SDG 16.</b> Promovoni shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, siguroni qasje në drejtësi për të gjithë dhe ndërtoni institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.</p>